



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 159, Janar 2017

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

EMERGJENCAT - PROBLEMET REALE APO SHOW

Shkak për këtë shkrim u bë një emision që mbrëmë ndjeka në TV Klan, në lidhje me situatën e emergjencës nga dëbora dhe ngricat në vend. Fillimisht kam objeksionet e mia në lidhje me fokusimin e problemit: kur do të analizosh mirë një çështje duhet fokusuar aty, e jo të hallkatesh në gjithë sa të "ndërsyen" mendja. Por kjo është çështje e drejtuesit të emisionit, ashtu siç është edhe struktura e panelit, pra të ftuarit në studio, apo organizimi i vetë emisionit: radha e analizës së gjerave, spotet, apo reklamat që futen kohe e pa kohë.



KËRKOJMË VËMËNDJEN TUAJ

Të dashur anëtarë të kryesisë dhe të Shoqatës "Atdhetare Dukagjini"! Të dashur miq dhe dashamirës të Dukagjinit dhe dukagjinasve kudo që ndodhen!

Kryesia e Shoqatës "Atdhetare Dukagjini" dhe grupi i punës pranë saj, që nga muaji qershor 2016, ka shpërndarë një ftesë që bën fjaleë për një platformë studimi për zhvillimin e arsimit dhe kulturës në Dukagjin. Në këtë vit që jemi mbushën plot 100 vjet që nga fillimi i hapjes së shkollave shqipe në Dukagjin. Është një gjë shumë e rëndësishme për historinë dhe kulturën e kësaj krahinë mjaftë të njohur në të gjitha periudhat e saj, por edhe të Shqipërisë.

NATA TRADICIONALE E DUKAGJINIT

- FOLK - 2017 -

Tashmë është bërë traditë që çdo fundviti të organizohet "Nata tradicionale e Dukagjinit", për të promovuar vlerat më të mira të trashëgimisë kulturore të Dukagjinit e më gjerë, duke i pasuruar ato me krijime dhe interpretime të reja.

Edhe sivjet, me datë 30 Dhjetor, u organizua event i 14-të i tij në Pallatin e Sportit të qytetit të Shkodrës, nga Shoqëria Kulturore Artistike "Treva", me drejtuesit e saj kryesor, tashmë shumë të afirmuar e të dashur për folkdashësit, ...

100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

ARSIM NË DUKAGJIN EO PËRMES VËSHITRËSISHË, POR PATI SHUMË SUKSES

(kujtime)

3

Unë, vlerësoj shume nismën për studimin e zhvillimit të arsimit dhe të kulturës në 100 vjetet e fundit në Dukagjin, të ndërmarrë nga shoqata Atdhetare Dukagjini, madje e quaj të një rëndësia të veçantë.

Kjo nisëm edhe mua më kthej në kohën e rinisë time, madje edhe të fëmijërisë. Në Ndërllysë, sot fshat i veçantë, për herë të parë është hapur shkolla fillore në vitin 1948 me fëmijët e lagjeve; Ndërllysë, Kaprrë dhe Gag. Shkëputja nga shkolla e Gimajve dhe sistemimi në shkollën Ndërllysë, i fëmijëve të lagjes Gag, është bërë për arsye që të plotësohej kontingjenti i nxënësve në shkollën Ndërllysë, me qëllim që t' u jepej mundësia fëmijëve të lagjes Kaprrë të shkonin në shkollën Ndërllysë dhe të mos mbeleshin pa shkollë. Kjo u bë edhe për fëmijët e lagjes Ndërllysë, të cilët shkonin në Theth dhe që e kishin shumë larg shkollën. Kjo ishte një masë shumë e rëndësishme, që garantoj ndjekjen e shkollës nga fëmijët e lagjes Kaprrë dhe shkurtimin e rrugës së fëmijëve të lagjes Ndërllysë. Ky akt i pushtetit lokal të kohës, duhet vlerësuar dhe të mbetet në historinë e arsimit në Dukagjin.

Nga Kolë Funiçi

Stani: Vendlindja, një dashuri që nuk mbaron kurrë

6

NË KUADRIN E DALJES SË LIBRIT "RRUGE PA KRYE", ME ESE LETRARE

Lazer Stani, pas shtatë vëllimeve me tregime, vjen para lexuesit me librin e ri me ese letrare "Rrugë pa krye". Lazer Stani, tashmë shkrimtar i njohur, ka një eksperiencë të madhe në fushën e gazetarisë, të publicistikës, anëtar redaksie në gazetën "Drita", në gazetën "Zërin e Rinisë", në gazetën "RD", në gazetën "Albania", e të tjera media të shkruara. Por mbi të gjitha, ai është shkrimtar, portretin e tij e bëjnë librat e shkruar prej tij, siç shprehet edhe vetë.

Një jetë të tërë në mes njerëzeve

7

- Një bisedim me z. Pjeter Delia -



"LULEBORË" NË ÇDO STINË

9

- RIKTHEHET NË SHKODËR PAS
27 VITEVE FESTIVALI I KËNGËS
QYTETARE "LULEBORË" -

Një fund viti në Shkodrën tonë gjithmonë përjetohet me ngjarje të shënuara artistike, festive e qytetare, ku natyrisht do të përmendim eventet më të rëndësishme, siç është "Sofra Shkodrane" e cila plotësohet kaq bukur dhe natyrshëm edhe me sofrat e tjera përreth që në mënyrën e vet mbledhin rreth tyre qytetarë të pasionuar pas qytetit, humorit dhe ahengut, të cilët sfidojnë edhe hallet e përditshme për të gëzuar një natë së bashku.

EMERGJENCAT – PROBLEMET REALE APO SHOW

Shkak për këtë shkrim u bë një emision që mbrëmë ndjeka në TV Klan, në lidhje me situatën e emergjencës nga dëbora dhe ngricat në vend. Fillimisht kam objeksionet e mia në lidhje me fokusimin e problemit: kur do të analizosh mirë një çështje duhet fokusuar aty, e jo të hallakatesh në gjithë sa të “ndërsyen” mendja. Por kjo është çështje e drejtuesit të emisionit, ashtu siç është edhe struktura e panelit, pra të ftuarit në studio, apo organizimi i vetë emisionit: radha e analizës së gjerave, spotet, apo reklamat që futen kohe e pa kohë.

Por, nuk dua të zgjatem me emisionin, pasi dua që ta trajtoj çështjen në thelb, e jo në aparençë. Kështu, realiteti është se që prej ndryshimit të sistemit, pra këto gati 27 vjet, emergjencat civile janë shfaqur në publik, në media e në terren, kryesisht duke bërë një lloj spektakli. Ky spektakël, në të gjitha rastet ka qenë në përputhje dhe në shërbim të qëndrimit të drejtuesit të qeverisë. Pavarësisht se drejtuesit e Qeverisë kanë ndryshuar, edhe drejtuesit e strukturave të Emergjencave Civile, kanë ndryshuar, por qëndrimi ka qenë i njëjtë, servilizëm dhe punë për spektakël.

Fillimisht duhet kuptuar qëllimi ngritjes e funksionimit të një strukture, fokusi kryesor i punës si dhe format e punës që përdor. Në vijim, duhet ditur edhe buxheti, logjistika dhe njerëzit që angazhohen për të përmbushur sa më mirë objektivat e caktuara. Në rastin konkret, sipas mendimit tim, Emergjencat Civile kanë një problem që lidhet me konfondimin e rezervës së shtetit, me ndërhyrjen për të shpëtuar apo lehtësuar situatën e njerëzve në nevojë të menjëhershme.

Rezerva e shtetit, pavarësisht nëse do të menaxhohet nga struktura e Emergjencave Civile, nga kjo apo ajo Ministri, ka të bëjë me një kontingjent të caktuar të mirave materiale, të ushqimeve, të veshmbathjes, të pajisjeve të ndryshme, e të tjera, që do të përdoren në raste që mund të përcaktohen me ligj apo edhe me urdhëresa (të nivelit që gjykohet nga Qeveria).

Ndërsa struktura për emergjencat, përbëhet nga njerëz të përgatitur si fizikisht ashtu edhe me njohuri, të trajtuar për situata të veçanta dhe të pajisura si duhet me mjete, pajisje dhe logjistikë që mundëson kryerjen e ndërhyrjes, shpëtimin e jetës së njerëzve, shpëtimin nga dëmtimi të të mirave materiale, por njëkohësisht nuk rrezikon vetë jetën e personelit të emergjencave.

Në këtë këndvështrim, ardhja e dimrit apo e pranverës, rënia e dëborës apo e shiut, apo edhe e breshërve në vetvete, nuk përbëjnë emergjencë. Në kushtet e vendit tonë, janë thujt mirë të përcaktuara të katër stinët: pra pavarësisht nëse ekziston apo jo struktura e Emergjencave, stina do të vijë: një vit më i egër, një vit më i butë, por do të vijë. Ndaj, asnjë nëpunës apo drejtues i strukturave të Emergjencës, apo të ministrisë përkatëse ku varen, apo të kryeministrisë, nuk ka pse na del në ekrane e të na thotë që ka trokitur dimri.

Ajo që kreu i qeverisë, ministri apo

ministrat përkatës, si dhe strukturat në vartësi të tyre mund të bëjnë është: të përcaktojnë sa fuqi ka buxheti i shtetit për të mbështetur njerëzit në nevojë. Këtu duhet ndarë në mënyrë shumë të qartë: sa mundësi ka për t’iu gjendur, për të ndihmuar njerëzit që jetojnë akoma në malësitë e vendit tonë, në zona larg nga qendrat administrative përkatëse dhe që në periudhën e vështirë të dimrit nuk kanë mundësi lidhje me rrugë automobilistike. Pavarësisht nga gjendja e buxhetit të qeverisë: pra pavarësisht nëse Qeveria ka mundësi që të ndihmojë X (një numër të caktuar) familje me 2 litër vaj dhe 5 kg miell, apo mund të ndihmojë me 20 litër vaj dhe 50 kg miell (dhe një listë me sasi të caktuara të produkteve të tjera të shportës ushqimore), duhet të bëjë edhe një plan të furnizimit të këtyre familjeve. Në këtë mënyrë, në muajin Shtator, apo edhe deri në Nëntor, struktura e ngarkuar nga qeveria, duhet të bëjë këtë shpërndarje, me korrektësi, me përgjegjësi dhe në një monitorim rigoroz të strukturave vendore.

Nëse do të veprohej kështu, shpërndarja do të kryhej duke përfshirë familjet që vërtetë kanë nevojë, do të kryhej në kohën e duhur (edhe ariu gjithmonë merr masat për dimrin, le më njeriu), dhe me kosto ku e ku më të lira sesa po të bëhet në “emergjencë”. Por, nuk është vetëm



kostoja që përbën shqetësim në rastin e shpërndarjes në kohën e “emergjencës”. Është pikë së pari, një konceptim dhe interpretim shumë i gabuar. Nëse ka ardhë dimri në Dukagjin, kjo është më se normale. Nëse ka rënë dëborë në Dukagjin në muajin Janar, kjo është më se normale. Nëse është bllokuar rruga nga reshjet e dëborës dhe është ndërprerë linja elektrike për shkak të reshjeve dhe të erës në Dukagjin, kjo është përsëri normale.

Atëherë, ku fillon anormaliteti?! Anormaliteti fillon menjëherë sapo Qeveria nis helikopter në një fshat të caktuar, për të hedhur nga lartësia 1 apo më shumë kuti, me një dreq e din se me çfarë produktesh është mbushur, a janë domosdoshmëritë e banorit apo janë sipas “oreksit” të një zyrtari që e ka shtëpinë në unazën e vogël të Tiranës. Anormaliteti fillon në momentin që “fryhen” mediat, frikësohet publiku dhe asnjë prej publikut nuk e din sa është fatura e shpenzimeve të “situatës emergjente”. Anormaliteti vazhdon, kur Qeveria, strukturat e saj, nuk marrin as-

një masë për të zhblokuar rrugën, aq sa rruga e Thetit hapet për makina në fund të muajit Prill e nganjëherë vetëm në fillim të muajit qershor. Anormaliteti vazhdon, kur fshatra të tërë (pavarësisht sa familje jetojnë, por së paku ka disa familje atje), lihen pa rrymë elektrike për muaj të tërë.

Anormaliteti vazhdon në përmasa humoristike, kur një ministër apo edhe më lart, shkon personalisht të vizitojë një fshat apo edhe një familje të caktuar në zonën e mbuluar me dëborë. Mirë që shkon ministri, por shkon me një “shpurë” shoqëruesh që në fund të ditës e kanë faturën shumë të fryrë. A thua ky ministër është kaq ekspert, që sapo të shikojë situatën, do të bëjë magji, do të japë zgjidhjen e duhur. Ka ikur koha (mirë që ka ikur), kur një ministër “frymëzon” popullatën dhe i angazhon ata në marrjen e masave dhe në stabilizimin e situatës.

Anormaliteti vazhdon më tej me dhënien e këshillave nga disa njerëz, qoftë edhe funksionarë që dëborën e kanë parë në internet, apo e mbajnë mend nga një ekskursion në fëmijëri. Si mund ti thuash një malësori që është lindur e rritur, e është pjekur si burrë në zonë ku rregullisht bie dëborë, që të pastrojë rrugën para hyrjes së shtëpisë, apo të marrë masa që të pastrojë çatinë. Në

edhe nga ujku apo ariu, të mund të njoftonin?!

Në paketën e caktuar të ndihmës nga qeveria mund të përfshiheshin edhe energji në fshatra ekstreme), mund të përfshiheshin libra, por mund të përfshiheshin edhe lodra të ndryshme, që nga domino apo shah, e kështu në vijim. Në paketën e ndihmës për këto zona, mund të përfshiheshin edhe rroba të përdorura, të cilat mund të mblidheshin me një fushatë sensibilizuese, ose edhe me një pikë të caktuar të grumbullimit (diku në qendra të qyteteve), të cilat mund të përdorëshin nga këta banorë, në situatën e dëborës, apo edhe pas saj. Kjo do të ishte një lloj ndihmese serioze dhe konkrete, e që do të ngjanin shumë më të besueshme e do të tregonin një angazhim ku e ku më serioz të qeverisë e të zyrtarëve, krahasuar me këshillën për të pastruar dëborën para shtëpisë së tyre apo për të ushqyer kafshët që mbarështojnë.

Anormaliteti vazhdon më tej, kur asnjë zyrtar i qeverisë, nga më i vogli e deri tek më i madhi, nuk arrin të tregojë se si u vihet në ndihmesë (në fakt të kryejë detyrën e vet ndaj shtetasve) në lidhje me shkollimin e fëmijëve, apo edhe me asistencën shëndetësore. Këto janë dy pika shumë delikate, shumë të rëndësishme e deri nevalgjike. Këto të dyja, së bashku me rrugën dhe energjinë elektrike, janë shkak e shpopullimit të zonave që nga të huajt quhen “perla”.

U pa si shqetësim ngarkesa në “Rrugën e Kombit”, pasi shumë kureshtarë shkolin atje vetëm për të parë dëborën, për tu kënaqur me familjarët e fëmijët e vet. A mendoni për një moment, sa do të ishte kurioziteti dhe dëshira e njerëzve për të kaluar një natë në Theth, apo në një fshat tjetër, për tu kënaqur me dëborën, por edhe për ta shënuar në jetën e tyre si një natë të paharruar. Nëse qeveritë do të bënin sado pak përpjekje për të plotësuar ato kushte minimale të përmendura më lart, atëherë me siguri që numri i familjeve që do të ishin sot në malësitë tona do të ishte disa fish më i madh. Kjo do të shtrinte turizmin në 12 muaj të vitit e do të siguronte të ardhura të mjaftueshme për banorët e do të “lejonte” qeverinë të vilte edhe të ardhura nga këto zona.

Kushdo që e lexon këtë shkrim, e ka të lehtë të kuptojë se çfarë i “mbetet në dorë”, emergjencave. Të jenë në gatishmëri për ndërhyrje, kur të sëmuret apo rrëzohet/pësojë traumë një banor, kur të ketë “humbur” një turist, apo kur të ketë ndonjë rast të rrëshqitjes apo dëmtimeve të tjera të paparashikuara.

Ndaj, kam një lutje për zyrtarët e këtij vendi, për zyrtarët apo edhe për funksionarë të lartë, për politikanë e drejtues të rangjeve të ndryshme: Ju lutem bëhuni më human! Ju lutem mësoni të kuptoni dhe të ndani situatat! Ju lutem këshillohuni me specialistët e vërtetë në mënyrë që ti vini sa më mirë në ndihmë popullatën (qoftë edhe me pak, por saktë), dhe jo të merreni me pjesën e shfaqjes!

Prof. Dr. Zef Gjeta

100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

ARSIM NË DUKAGJIN ECI PËRMES VËSHIRËSISHË, POR PATI SHUMË SUKSES

(kujtime)

Unë, vlerësoj shume nismën për studimin e zhvillimit të arsimit dhe të kulturës në 100 vjetët e fundit në Dukagjin, të ndërmarrë nga shoqata Atdhetare Dukagjini, madje e quaj të një rëndësia të veçantë.

Kjo nisëm edhe mua më kthej në kohën e rinisë time, madje edhe të fëmijërisë. Në Ndërllysë, sot fshat i veçantë, për herë të parë është hapur shkolla fillore në vitin 1948 me fëmijët e lagjeve; Ndërllysë, Kaprrë dhe Gag. Shkëputja nga shkolla e Gimajve dhe sistemimi në shkollën Ndërllysë, i fëmijëve të lagjes Gag, është bërë për arsye që të plotësohej kontingjenti i nxënësve në shkollën Ndërllysë, me qëllim që t'u jepej mundësia fëmijëve të lagjes Kaprrë të shkonin në shkollën Ndërllysë dhe të mos mbeteshin pa shkollë. Kjo u bë edhe për fëmijët e lagjes Ndërllysë, të cilët shkonin në Theth dhe që e kishin shumë larg shkollën. Kjo ishte një masë shumë e rëndësishme, që garantoj ndjekjen e shkollës nga fëmijët e lagjes Kaprrë dhe shkurtimin e rrugës së fëmijëve të lagjes Ndërllysë. Ky akt i pushtetit lokal të kohës, duhet vlerësuar dhe të mbetet në historinë e arsimit në Dukagjin.

Unë jam futur në shkollë po në vitin 1948, në klasën e parë dhe kam qenë 10 vjeç. Mësuesit e parë ishin: Xhevat Xhela nga Barbullushi Shkodër, Zef Gjeloşi nga Thethi, Gjon Dianizi nga Shkodra, Dodë Grima nga Gruemira. Numri i nxënësve në klasën e parë ishte 14.

Në verën e vitit 1970 erdhi në Breg-Lumi ministri i arsimit dhe i kulturës Thoma Deliana, bashkë me Prekë Sokolin, ish sekretar i Kom. Ekz. k. pop. të Rrethit. Unë u caktova të bëj ekspozenë e arsimit në Dukagjin. Ekspozenë e përqendrova, në arritjet në fushën e arsimit në Dukagjin, vështirësitë dhe dobësitë dhe të metat, si dhe në masat që mendonim ne si organe shtetërore në zonë, që ishin marrë dhe po merreshin për shkuarjen drejt minimizimit të tyre, por shtruan edhe kërkesa për të çuar më tej punën në arsim dhe kulturë. Kjo paraqitje për gjendjen e arsimit në Lokalitetin e Dukagjinit u prit shumë mirë nga Ministri dhe Sekretari i komitetit ekzekutiv i rrethit Shkodër.

Në shtatorin e vitit 1970, me insistimin e pushtetit lokal, dhe me miratimin e Komitetit ekzekutiv në Shkodër, në Kaprrë u hap shkolla fillore, ku fëmijët e 11 familjeve do të mund të arsimoheshin pranë shtëpive të tyre. Edhe ky, është realizim që meriton të mbetet në historinë e arsimit Dukagjin. Me kalimin e kohës, pati raste që kjo shkollë të kishte pak nxënës, madje edhe me kaq nxënës ajo nuk u mbyll deri nga fillimi i viteve '90. Të hapet dhe mbahej hapur një shkollë fillore për kaq pak nxënës, ose edhe me më pak ishte e paparë dhe e dëgjuar.

Por kjo u bë sepse për nxënësin 6 vjeçar ishte e pamundur të shkonte në shkollën Ndërllysë, ku i duhej të bënte tre orë rrugë në ditë për të shkuar dhe për t'u kthyer në shtëpi. Gjithashtu edhe rruga ishte mjaftë e vështirë për nxënësit në këtë moshë. Mësuesi i parë në Kaprrë ishte, Marash Gjeloşi Staka nga Nënmarvriqi. Po në këtë kohë u hap shkollë edhe në Mollë të Shoshit.

Në vitin shkollor 1974-1975, ishte viti i dytë i hapjes së shkollës së mesme Breg-Lumi. Numri i nxënësve në vitin e parë arinte në 27 nxënë, femra 4. Shkolla ishte bashkë tetëvjeçarja dhe e mesmja, pra me një drejtor. Kuadri mësimor që jepte mësim që kujtoj unë ishin, Unë, Kolë Funiçi, Ndue Gjonaj, Fran Vatë Nikaj, Fatos Gjyzezi, Fozilet Gjyzezi, Agim T'horja, Shkurte Rusheta, Luigj Shyti, Yllka Nako, Gjovalin Gjini, e të tjerë që për momentin nuk po më kujtohen.

Shkolla e mesme bujqësore Breg-Lumi, Dukagjin, për vitin arsimor 1974-1975, është vlerësuar nga seksioni i arsimit dhe i kulturës dhe Kom. Ekz. k. p. Rrethit Shkodër, për: planifikim shkencor të punës mësimore-edukative, gjallërimin e jetës së këshillit pedagogjik, dhe tërë jetës dhe punës së procesit mësimor-edukativ, rritjen e cilësisë, kualifikimin e trupës mësimore, forcimin e disiplinës në punë të kuadrit dhe rregullit dhe disiplinës së nxënësve. Gjatë vitit shkollor 1974-1975, në shkollën e mesme bujqësore Breg-Lumi, Dukagjin tërë veprimtaria e shkollës ka pasur ecuri të dukshëm pozitiv.

Unë kam punuar si drejtues shkollë edhe në disa shkolla në zonën e Shalës. Në vitet 1975-77 në Theth dhe kujtoj këta mësues: Vinçenc Dabërdaku, Luigj Shyti, Islam Tuzi, Prenda Quku, Zef Bari, Pal Rupa, Elena Selmani, e të tjerë. Në vitet 1977 - 1983 kam punuar në Abat dhe kujtoj këta mësues: Fran Çardaku, Alfred Fishta, Fran Dardha, Viktor Pali, Dila Dardha, Lajde Mema, Tonë Mekshi, Ndue Quku, Age Arra, Vera Sokoli. Në shkollën te Ura e Re që përfshinte nxënësit e Lotajve dhe Vuksanajve, por shkollat anekse të këtyre fshatrave, kujtoj këta mësues: Prelë Shytani, Lazër Fusha, Gëzim Mahmutaj, Pashko Camaj, Mhill Leka, Luke Mjajaj, Pal Marku, Pjetër Delaj, Gjyste Gila (Shyti).

Në drejtimin e shkollave në zonën e Shalës kanë dhënë ndihmesën e tyre edhe shumë drejtues me përvojë por edhe shumë të përkushtuar si Prelë Grimaj, Muhamet Bishja, Pal Rupa, Muhamet Shala, Ndue Zef Toma, Gani Isufi, Prekë Sokoli, Ndoc Grimaj, Sebiha Kopliku, Mahir Hoti, Tasim Milloja, Aishe Karaj, Prelë Shytani, Luigj Shyti, Lazër Fusha, Shpëtim Lame, Mehdi Kroni, Zef Fusha, Pjetër Smakaj, Osman Paruca, Dedë Mojsiu, Tomë Bumgaja, Syka Çarku, Lena Fu-

sha, Martin Çetina, Islam Semanaj, Ndue Shytani, e të tere. Po kështu në Shosh, kujtoj drejtorët e shkollave si: Zef Fusha, Fran Dardha, Agim Fasllia, Zef Toka, Prekë Vuksani,

Krahas punës arsimore, mësuesit dhe shkolla në tërësi janë marrë vazhdimisht edhe me nxitjen dhe zhvillimin e kulturës. Krahas asaj punë për të studiuar dhe mbledhur kulturën popullore me ato mundësi që kishim, u përshinë shkollat për zhvillimin e veprimtarive kulturorë dhe artistikë në fshatrat e Dukagjinit, duke u nisë në bazë fshati, veçanërisht në fshatrat e mëdhenj. Duhet shënuar puna që bëhej në vatrat e kulturës në Theth, shtëpinë e kulturës në Breglumi, në Shosh dhe në Pult. Synohej që për çdo fshat të kishte një vatër kulture, apo thjeshtë një qendër kulturore, ku mund të bëheshin veprimtari të ndryshme, qofshin këto edhe mbledhje e takime të ndryshme krahas veprimtarive artistike. Mësuesit me durim dhe dashuri ishin të parët në organizimin e veprimtarive. Shumë të bukura dhe me vlerë ishin konkurset dhe olimpiadat në bazë zone dhe në qendrën e lokalitetit në ato kohë. Po kujtoj këtu disa nga drejtuesit dhe organizatorët ku ka pasur në shumë veprimtari si Gjergj Çuni, Ndue Quku, aktoren e njohur Violeta Deda, Zef Livadhi, Dedë Shtëpia, Ndue Deda, Pal Rupa, por edhe këngëtarë dhe instrumentist si: Mhill Çuni, Gjergj Marku, Kolë Dema, Marash Ndou, Kolë Gjoni, Kujtim Funiçi, Prelë Bregu, Zojë Kola, Dedë Zefi, Lulë Deda, Pult, e të tjerë.

Puna me librin filloi aty nga fundi i viteve '50, por më me forcë u punua nga fundi i viteve '60 dhe në vazhdim. Filluan hapat e para në këtë fushë, si në Theth e në ndonjë shkollë tjetër, por ngritja ecte shumë ngadalë. Kjo sepse: e para, gjendja ekonomike nuk e ndihmonte aspak këtë çështje dhe e dyta mungonte kultura e leximit dhe të studiuarit, prandaj u kërkua që të punohej në këtë drejtim. Problemi ishte që libri të futej në familjet malësore, sepse në shkolla ishte diçka që mund të bëhej në mënyrë më të organizuar nga shteti, dhe ashtu u bë. Në ballë përsëri si edhe për shumë e shumë probleme të kohës dolën mësuesit, duke bërë përhapjen e librit, duke publikuar atë dhe duke ndihmuar me sa mundësi që kishin. Në vitin 1969, ne si pushtet në qendër të lokalitetit ngritëm librarinë e parë, duke tregtuar një masë të konsiderueshme librash të fushave të ndryshme; shkencore, politike, artistike, letrare etj. Vendosëm si shitës në këtë librari të ndjerin Zef Rusheta. Per kete person, mund të them se derisa ndërroi jetë, punoi fort mirë në këtë librari. Ai e donte librin dhe i kishte lezet mënyra se si e tregtonte atë. Ai kërkonte të njihej me tubimet e njerëzve në mbledhjet e fshatrave. Këtë e kërkonte

sepse një ditë përpara bënte gati librat që do të merrte në çantën e shpinës, për t'i tregtuar. Unë e kam marrë me vete disa herë në mbledhjet e popullit të fshatrave Kir, Khan të Pultit, Shosh, e të tjera. Sidomos pas vitit 1968 e në vazhdim, u ngrit me forcë ngritja e bibliotekave për çdo familje. Natyrisht edhe këtu të parët ishin mësuesit dhe kuadrot e kohës. Në fakt, më përgjithësi çdo ekonomi ngriti këndin e librit, kush më shumë e kush më pak. Koha ishte e tillë që, këto kënde libri, në shumicë kishin karakter politik, por edhe shumë me tematikë tjetër. Do të ishte mirë që edhe puna me librin të mbetet e shënuar në rrugën 100 vjeçare të arsimit dhe kulturës në Dukagjin.

Vitet e para pas çlirimit shtruan problemin e luftës kundër analfabetizmit edhe në krahinën e Dukagjinit. Që në vitin 1946 filluan kurset kundër kësaj plage, në të cilën u përfshin njerëz në moshë deri 40-50 vjeç që të mësonin shkrim e këndim. Kjo veprimtari pastaj vazhdoi me etapa edhe në vitet e mëvonshme. Në vitin 1946 në lagjen time të vendlindjes, u hap për herë të parë një kurs kundër analfabetizmit, me këta pjesëmarrës: Lulë Markja, Groshe Funiçi, Zojë Kola, Gjeloşi Kusuri, Mark Fusha, Zef Fusha, Linë Zefi, Zojë Vata, Kolë Gjoni, Linë Pjetri, Shytë Kola. Gjithsej 11 kursistë, prej tyre, femra shtatë. Drejtues i këtij kursi u caktua Fran Gjeloşi. Disa vite me vonë kam qenë edhe unë drejtues në këto kurse në Kaprrë. Dhoma e mësimit ishte në shtëpinë e Prekë Ndue Lekës, sot shtëpia e Nikollë Pjetrës.

Kishin vetëm me dy mjete mësimore; me nga një laps plumbi dhe një fletore të improvizuar. Pak shpjegim, për fletoren e improvizuar dhe thikën. Kishim përgatitë rreth 14 dërrasa me dimensione 20x30 cm. Dërrasat i kishim rregulluar mirë tek një mjeshtër me zdrukth. Ishin bërë shumë të lëmuara. Kishim përgatitë edhe 3-4 thika me hark, me dorezë prej druri dhe tek pjesa e hekurit i kishim dhënë formën e harkut. Forma e harkut i ishte dhënë thikës për arsyen e vetme, që në dërrasë kursisti të shkruante shkronja, numra, rrokje, fjalë, fjali, veprime aritmetike e të tjera dhe pastaj për ta fshirë e për t'i liru vendin punës e punimit tjetër, pra duhej një mjet, për ta hequr shkrimin, funksionin e këtij mjeti mund ta kryente vetëm thika, vetëm kjo thikë e harkuar. Kursisti e kruante sipërfaqen e dërrasës dhe së bashku me shenjat e lëna nga lapsi hiqte edhe një pjesë të vogël të dërrasës, në formë lëvozhge. Kështu dërrasa bëhej gati për punë tjetër.

Duhet theksuar se përdorimi i kësaj fletoreje të improvizuar, bëhej nga nevoja sepse në këtë periudhë ishte shumë e vështirë, ose e pamundur të siguroheshin fletore në atë momente. (vijon në f.10)

KËRKOJMË VËMËNDJEN TUAJ

Të dashur anëtarë të kryesisë dhe të Shoqatës "Atdhetare Dukagjini"!

Të dashur miq dhe dashamirës të Dukagjinit dhe dukagjinave kudo që ndodhen!

Kryesia e Shoqatës "Atdhetare Dukagjini" dhe grupi i punës pranë saj, që nga muaji qershor 2016, ka shpërndarë një ftesë që bën fjalë për një platformë studimi për zhvillimin e arsimit dhe kulturës në Dukagjin. Në këtë vit që jemi mbushën plot 100 vjet që nga fillimi i hapjes së shkollave shqipe në Dukagjin. Është një gjë shumë e rëndësishme për historinë dhe kulturën e kësaj krahinë mjaft të njohur në të gjitha periudhat e jetës sa saj, por edhe të Shqipërisë.

Studimi i zhvillimit të arsimit dhe kulturës në këtë zonë nuk është vetëm dëshirë por së pari është detyrë e jona, për tua lënë brezave që vinë. Për këtë jemi mbledhur, kemi diskutuar dhe kemi rënë dakord që ti hyjmë kësaj pune dhe është shprehur mendimi i plotë se mund ta arrijmë. Natyrisht në asnjë rast jo vetëm, por me ndihmën dhe mbështetjen e atyre që kanë punuar në ato zonë në të gjitha kohërat, ka njohuri për zhvillimin e arsimit dhe kulturës, njohin dhe kujtojnë shumë momente gjatë punës, kujtojnë shumë kolegë me të cilët kanë punuar, sepse duhet vlerësuar puna e të gjithëve, pa të cilën nuk do të arriheshin ato që u arritën, dhe duhet thënë se u arrit shumë, madje më shumë se sa mendohet nga disa, sidomos nga ata që i kanë njohur këto zona nga larg, ose me anë delegatësh.

Janë shpërndarë mbi 200 ftesa sa kemi pasur mundësi për të përfshirë të gjitha zonat e dukagjinit, por edhe të gjithë ata që kanë dhënë ndihmesën e tyre në këto zona, në këtë krahinë. Është bërë njoftim në formë thorrjeje edhe në gazetën Dukagjini. Pra ka pasur një nxitje të mirë. Të gjithë e kanë pritur mirë dhe e kanë quajtur të domosdoshme këtë studim që ka ndërmarrë shoqata, dhe kanë shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar. Na kanë ardhur kujtime të shkruara dhe foto, por edhe dokumete nga disa basjkëpunorë. Duhet vlerësuar fakti që intelektual si Prof. Gjovalin Kolombi është përgjigjur brenda pesë ditëve me mjaft të dhëna interesante dhe foto. Po kështu kanë sjellë të dhëna të vlefshme Zef Deda, ish drejtor shkolle dhe ish deputet në Shllak, Ruzhdi Poda ish drejtor shkolle në Telumë, Kolë Funiçi ish drejtor shkolle dhe drejtues në organet e pushtetit lokal të kohës, Dedë Toka nga Shoshi, Nikollë Gjakë Bregu, Tasim Mlloja, Shpetim Lame, Ndoc Prendushi, Fran Lisi, etj. Ka pasur edhe nga ata që megjithëse nuk u është drejtuar ftesë, janë ofruar vetë, siç është rasti i piktorit Pjerin Sheldia i cili na ka sjellur materiale interesante.

Të dashur miq dhe bashkëpunorë!

Koha ecen, kalon. Ne i kemi hyrë kësaj pune por, si gjithmonë, kemi pasur parasysh mbështetjen tuaj që të arrijmë objektivat dhe synimet që i kemi vene vehtes bashkarisht. Ajo pjesë që na ka ardhur është e mirë por është e vështirë që vetëm mbi atë bazë të kalohet në etapat e mëtejshme të studimit. Sipas planit të miratuar, këtë vit do të bëhet edhe një konferencë shkencore në lidhje me arsimin dhe kulturën në Dukagjin në njëqindvjetëshin e fundit. Prandaj ju kujtojmë por edhe ju bëjmë thirrje që sa më shpejt të jenë e mundur të mundë të mbledhim më të mirat e mundshme për këtë veprimtari mjaft të rëndësishme dhe me shumë interes për krahinën e Dukagjinit, për të sotmen dhe për brezat që vijnë.

Ju mirëpresim me shumë respekt.

**Grupi i punës pranë Kryesisë
së Shoqatës "Atdhetare Dukagjini"**

27 janar 2017

"Migjeni" i çliruar nga hekurat!

Shpeshherë në qytetin tradicional dhe të madh të veriut, e kanë si zakon, ju ka mbetur si "ves", të krenohen me të dikurshmen e tyre, me krenarinë e lavdisë së kaluar, por që nuk vazhdon të trashëgohet dhe rikthehet në kohë. Kohët e fundit ka filluar dhe një lloj "rivlimi" për "djepin e dikurshëm" që pikërisht ka mbetur një metaforë dhe as nuk është rritur më tepër se sa kaq, por dhe nuk ka prodhuar ashtu si më përpara. I ka këto, një qytet i vjetër, dikur qendër Vilajeti, apo më përpara një domen venedikas kultur- alisht dhe me kodekse të tilla, por edhe akoma më përpara një lavdi luftrash dhe zotërimesh Balshajsh e Dushanësh, për të shkuar thellë në modele romane dhe ilirike. Legjendat dhe modeli përrallë, epizmi dhe mitet, e bëjnë një nga qytetet që si dramatikën dhe humoristikën i luan gjithmonë në shoqërinë e tij që ndër kohë, transformohet herë bujshëm dhe herë drastikisht mbyllur, si në një dhomë qilari të errët, ku drita e qiriut "zëvendëson" diellin. Sigurisht që krenari është "Migjeni" ose teatri i famshëm i Shkodrës, i krijuar në kohë të një Shqipërie mbas luftës dhe në hovin e ndërtimit të një jete tjetër dhe pse në një regjim diktature. Ai u ngrit, duke shfrytëzuar si trashëgiminë e grupeve dhe lëvizjes si kulturore dhe politike të lagjeve dhe Shkodrës, si qytet përparimtar dhe më i qytetëruari në trevat shqiptare. Por teatri i Shkodrës, lindi si një frymëzim i lëvizjeve amatore që u kthyen në kulmin e tyre në lëvizjen më të fuqishme teatrore dhe të spektaklit, të humorit, këngës dhe valles, traditës dhe muzikës moderne - në mënyrë të jashtëzakonshme. Ky teatër është absolutisht vendi më i rëndësishëm i shfaqjeve në Shqipëri për nga numri i tyri dhe po ashtu nga plejadat e vazhdueshme të aktorëve, humoristëve, instrumentistëve, regjisorëve, skenaristëve libretistëve, punëtorëve të skenës që ka nxjerrë përgjatë viteve 1957-1990, por patjetër dhe në vazhdim. Nuk është e nevojshme të përmend emra, sepse e para, i kam përmendur gjithmonë në shkrimet e mia dhe e dyta janë kaq shumë, sa duhen edhe shumë faqe të tjera dhe kalojnë gjerësisht temën e sotme të shkrimit opinion. Sot teatri nënkupton ndërtesën, por në fund të fundit, shkodranët kuptojnë institucionin. Ajo (ndërtesa) kur përfundoi, lindi e pa rrethuar me hekura, pa gardh anash, e pa rrethuar për tu mbrojtur nga jashtë brenda. Përkundrazi, për të qenë e "joshëshme" kishte pemë të mbjella dhe oborr. Jetoj ashtu deri sa erdhën kohë që sollën gardhin, rrethimin me hekura. Kohë sidomos mbas viteve 1990-të që duhej të mbronin institucione, monumente kulture (kështu është dhe teatri Migjeni) kohë që rrezikuan dhe vijojnë të rrezikojnë artin e dikurshëm dhe penalizojnë atë të sotmin. Erdhën kohë gardhesh jashtë "Migjenit" dhe gardhesh psikologjikë, etikë, tragjikë, jo kompatibël me demokracinë, pengesë për ritmin artistik dhe po ashtu për përshtatjen me tregun dhe realitetin e ri kulturor. Institucionet në Shkodër si ish Prefektura dhe sot Bashkia larguan gardhet. Ndonjë institucion religjionar po ashtu largoi gardhet, institucione të tjera të shtetit i hoqën gardhet përfshi dhe ndonjë institucion mes kulturës dhe arsimit privat dhe shtetëror. Por gardhi ka mbetur në "Teatrin Migjeni" dhe disa institucione shkollore dhe akademike. Gjithsesi e kam fjalën te Teatri "Migjeni" posaçërisht. Ai duhet të largojë gardhin e hekurit që e rrethon. Ai gardh nuk vlen më, Nuk duhet më aty, dhe për te, nuk janë dakord në përgjithësi njerëzit që punojnë aty dhe që nuk punojnë, por e ndjejnë prezencën e rëndësishme kulturore të tij. Për atë gardh nuk besoj se janë dakord aktorët, dhe nuk është dakord as drejtore Rita, me gëzim është marrë vesh se nuk është dakord as kreu i bashkisë Ademi, (madje e paska marrë dhe si një angazhim) nuk janë dakord as intelektualë të shumtë në Shkodër? Atëhere pse vazhdon të qëndrojë atje? Më kujtohet para shumë vitesh kur po largoheshin gardhet e krijuara në '97-tën nga institucionet e shtetit që me drejtorin e asaj kohe, po e bisedonim dhe punën e gardhit të " Migjenit" dhe sigurisht ai ishte dakord, por kishte dyshimin në se do të ishte momenti i duhur - ai në atë kohë. Sot ai gardh duhet larguar fare. E para, sepse nuk bën, është anakronik dhe aspak një dekor për një institu- cion kulture si teatri "Migjeni". E dyta, nuk ka teatro të kulturës europiane që kanë gardh anash tyre. E treta, largimi i gardhit jashtë, kam përshtypjen se ndikon dhe në largimin e një gardhi virtual brenda. Po, sigurisht në krijimin e institucionit të hapur, interkomunikues dhe me brendinë aspak "enigmë" dhe po ashtu të rivalizuar. Teatri ka mbetur në Shkodër në një këmbë në diktaturë si organizim dhe formë, dhe në një këmbë në demokraci, pa bërë kalimin aspak të sigurtë në kohën e sotme. Ai jeton si në diktaturë me financimin e Bashkisë, duke "kujtuar se do të mund të konkurojë Komitetin Ekzekutiv"? Në fakt e kanë gabim, sepse nuk e konkurojnë dot. Ky "gardh psikoartistik" duhet larguar dhe duhet gjetur mënyra se si. Nuk është e zonja bashkia ose nuk mund të barazohet ajo, me aftësinë e Komitetit Ekzekutiv, i cili e kishte teatrin mjet propagande të Komitetit të Partisë, dhe për këtë gjë, as i mungonin fondet dhe as organizimet dhe as forcat krijuese në terren. Sot teatri "Migjeni" nuk është mjet propagande partie dhe bashkie. Ai është një vend kulturor i jashtëzakonshëm i trashëgimisë së madhe shkodrane dhe shqiptare, dhe ka për detyrë jo propagandën për kulturën kombëtare dhe qytetare. Sigurisht që e bën, por mënyra tashmë është vjetruar dhe administrimi i cili shkon deri te rroga 200 euro nuk vlen më. Largimi i gardhit jashtë, mbase ndikon dhe në fillimin e një përshtatje për largimin të një gardhi tashmë jo normal brenda. Të një gardhi që plak format dhe përmbajtjet (deri në shfaqje) dhe po ashtu njerëzit miratimin unanimit të ndryshimeve kushtetuese nga Kuvendi i Shqipërisë dhe për të vijuar më tej me çlirimin e ligjit të vetingut dhe nisjen e një procesi të pandalshëm për të finalizuar institucionet e drejtësisë dhe ndëshkues krimin e korrupsionin në vend. Në këtë kuptim, politika e vjetër po shtegton me të shkuarën, sepse në zgjedhjet e ardhshme të 18 qershorit, pak politikanë të inkriminuar do të arrijnë të jenë në garën për deputet, pra është nisja e një sipari të ri për politikën shqiptare sepse një brez i ri politikanësh kanë marrë përgjegjësi për t'i dorëzuar pushtetin brezit tjetër, gjë që duhet të ndodhte edhe më parë! Një pritje e gjatë në post- diktaturë por që ia vlejti, pasi shqiptarët lanë pas një regjim despotik dhe hasën demokracinë, lirinë dhe bollëkun, dhe tani më janë në fazën e konsolidimit të të drejtave, drejtësisë, shtetit të së drejtës dhe vetë demokracisë. e super talentuar të "Migjenit"! Sipas meje të fillojë largimi i gardhit jashtë, sepse ai e bën më të lehtë dhe atë largimin e "gardhit" brenda, të rivalizimit dhe gjetjes së formave dhe përmbajtjeve të reja, për këtë teatër të jashtëzakonshëm në Shkodër. Njerëzit, drejtuesit nuk është se nuk i dinë të dy gardhet, por nganjëherë rutina, jetesa e gjatë me një gardh, drobitja në saj të ankesës së gjithmonshme dhe mos gjetja asnjëherë zgjidhje - e bën të vetën.

Sot "Migjeni" është më i lyer, më i rregulluar, më i ndriçuar dhe më i sigurtë. Largojeni gardhin që ka përreth dhe atë mënyrën e shëmtuar të shitjeve rreth e përqark trotuareve të tij, si një rudiment të një "lirie" për një kapitalizëm rrumpallë, të pa drejtë e injorant, i cili kërkon gjithmonë të mbysë artin, rre- thojë kulturën, dhe ta bëjë atë si veten. Hiqni gardhin nga "Migjeni" çlirojeni atë nga hekurat. Pastaj jepini dhe lirinë e kreativitetit të jashtëzakonshëm të tij.

Besi BEKTESHI

NATA TRADICIONALE E DUKAGJINI

- FOLK - 2017 -

Tashmë është bërë traditë që çdo fundviti të organizohet "Nata tradicionale e Dukagjinit", për të promovuar vlerat më të mira të trashëgimisë kulturore të Dukagjinit e më gjerë, duke i pasuruar ato me krijime dhe interpretime të reja.

Edhe sivjet, me datë 30 Dhjetor, u organizua event i 14-të i tij në Pallatin e Sportit të qytetit të Shkodrës, nga Shoqëria Kulturore Artistike "Treva", me drejtuesit e saj kryesor, tashmë shumë të afirmuar e të dashur për folkdashësit, Fran Kodra e Ndue Shytani. Vitet e tjera kjo veprimtari është zhvilluar në Teatrin "Migjeni", i cili asnjëherë nuk i plotësoi kërkesat

e dukagjinaseve e të tjerë për ta ndjekë këtë event, prandaj për të plotësuar sa më shumë kërkesat e tyre u zhvillua në Pallatin e Sportit me kapacitet më të madh, në të cilin pjesëmarrësit nuk e ndjenë të ftohtin përballë duartrokitjeve dhe ovacioneve, për cilësinë krijuese e interpretuese të këtij ansambli të mrekullueshëm. Kjo veprimtari fare mirë mund të quhet një festival folklorik, në të cilin fitues janë të gjithë, sepse pothuajse të gjitha krijimet ishin të reja me tekst e muzikë të kantautorit më të talentuar të veriut të Shqipërisë, z. Fran Kodra.

Të kesh kaq auditor, ku siç thoshte komentatori i madh Anton Mazrreku: "nuk kishe ku të hidhe kokrrën e mollës" dhe të bësh një eveniment të tillë burimor duke sjellë çdo vit gjëra të reja e kaq të pranueshme për shikuesit e dëgjuesit, mund ta bëjnë vetëm ansambli folklorik "Treva" edhe pse pothuajse gjithçka me kontribut vullnetar.

Kjo natë tradicionale u hap me një këngë të re për Nënë e madhe të 5 kontinenteve, e cila u kthye në shenjtoren Terezë, që mbodhi paqe e mirësi në çdo skaj të botës, me tekst e muzikë të Fran Kodrës, interpretuar shumë cilësisht nga binomi shumë i afirmuar Kodra-Shytani, të cilët si gjithmonë morën duartrokitjet e publikut. Ndër të tjera në këngë thuhet: "Shën Tereza, Nanë e njerëzimit/ je shejtnore e çdo besimit/ para Zotit na kja halin/ na ndihmo ta mposhtim djallin". Nga viti në vit në këtë veprimtari ka pas prurje të reja. Edhe në këtë vit u paraqit me një zë melodioz i riu Daniel Kopcaj nga Pecaj të Shalës, i cili u paraqit me këngën e përgatitur enkas për të "Kjo Shqipri burrat ku i ka", e cila e shoqëruar me lahutë dhe nga interpretimi dinjitoz fitoi entuziazmin e publikut. Ishin shumë kuptimplote vargjet: "Iajm i zi prej Dukagjinit/ asht shemb varri i Kostandinit/ kanë mbet kullat shkreh në dimën/ dera hapë pret Doruntinën/ Rozafati n'pikë të hallit/ çou Rozafë e naj thuej djalit/ qit kushtrimin kala n'kala/ kjo Shqipri burrat ku i ka".

Në këtë veprimtari nuk munguan as të ftuarit. Shumë denjësisht u paraqit

para auditorit këngëtari i talentuar nga Lezha, Gjovalin Nikolla me këngën "Sofra Shqiptare". Si gjithnjë, shumë denjësisht u paraqit këngëtari i talentuar Gjovalin



Shani me këngën "Jam shqiptar e jam shoshjan". Spektatorin e bëri për vete i ftuari tjetër, këngëtari i mirënjohur nga Malësia e madhe z. Arben Delaj, i cili u paraqit me këngën "Vajzat e malësisë", bërë enkas për të nga kantautori Fran Kodra. Si në çdo veprimtari të kësaj natyre edhe kësaj radhe u paraqit me grupin e valleve dhe të vegjlit e baletit nga profesionisti Aldo Nika, grup i cili shoqëroi edhe shumë këngë. Si gjithnjë, edhe kësaj here, e bëri për vete publikun këngëtari shumë i kërkuar Pëllumb Vrinca, i cili u paraqit me këngën "Dukagjin e malësi".

Shumë denjësisht e përfaqësuan në këtë festival nga zona e Nikaj-Mërturit, këngëtarët e talentuar Nikolin Përpall e Bardhok Përbiba, të cilët me zërat e tyre melodioz e të pastër si uji i bjeshkëve tona, interpretuan këngët "Kulla e mërgimitarit" dhe "Viset e mija". Pjesë e kësaj veprimtarie ishte edhe humori si:



Mitër Ndreshaj "Dasma dje e sot" apo të përherëshmit Gegë Shpati dhe Gaci e Qazimi, me humor të kohës, të cilët nxitën të qeshura pafund. Nga emigracioni, për këtë event kishin ardhë edhe, këngëtari i mirënjohur Petrit Gjini, që interpretoi këngën "Jam dej me raki" si dhe, Gjin Shani shumë i afirmuar kohët e fundit, i

cili interpretoi këngë për kurbetin.

Për të përshëndet këtë natë tradicionale kishte ardhë nga Lezha këngëtarja Nora Ndreu, e cila interpretoi këngën "Shif e ban e mos t'vet kënd/ mos ndigjo veç shpirtin tand". Dueti Fran Kodra e Ndue Shytani, mbasi interpretuan në këngë të re dasme, bashkë me këngëtarën Anila Kodra interpretuan siç dinë ata këngën lirike "Moj e mirë/ lidhe qenin me zinxhir". Prurjet e reja në këtë aktivitet po e pasurojnë folklorin dhe ai po transmetohet nga brezi në brez, një anë shumë pozitive. Të tillë të rinj ishin edhe Zef Marku e Kristjan Zalli që interpretuan këngën "U kput teli i çiftelisë" dhe Admir Prebibaj me këngën "Zana e bjeshkës", të cilët me interpretimet e tyre nuk ju lanë gjë mangut atyre të afirmuar. Nuk kishte si të mungonte në këtë event këngëtarja e talentuar, bashkëkëngëtarja me duetin Kodra-Shytani, Anjeza Ndoj, ardhë enkas nga Amerika, e cila interpretoi dy këngë të reja lirike, të cilat si gjithnjë i këndoi shumë cilësisht. Mjaft mirë e interpretoi këngën e saj anëtarja e grupit Treva, Viola Shqau.

Kjo veprimtari nuk mund të bëhej pa kontributin financiar të sponsorëve dukagjinase, që më kryesorët dhe të përherëshmit janë: Tonin Kamberi, Viktor Arrinaj, Gjovalin Gjellaj (me banim në Detroit), Martin Cubi, Gjergj Livadhi e të tjerë...

Këtë eveniment e vlerësuan maksimalisht edhe drejtuesit e "Unionit artistik mbarëkombëtar", presidenti – Mjeshtër i Madh, Azgan Haklar dhe sekretari i përgjithshëm i tij, Minella Kureta, të

blit artistik të Dukagjinit. E nderuan me pjesëmarrjen e tyre këtë event: Gjergje Leqejza – Konsull nderi i Austrisë dhe Nënkrjetar i Shoqatës "Atdhetare Dukagjini", z. Arben Gjuraj – Nënkrjetar i Bashkisë Shkodër, Këshilltarë, drejtues shoqatash të ndryshme dhe shumë figura të jetës politike, ekonomike e shoqërore të qytetit të Shkodrës. Është rast i veçantë, në të gjitha veprimtaritë që bëhen në fund të vitit, në të cilat të gjithë këngëtarët interpretojnë me veshjen tradicionale kombëtare duke ruajtur e pasuruar trashëgiminë kulturore dhe etnografike, në këtë veprimtari u ekspozuan veshje më karakteristike e zonës së Dukagjinit si: mitani, xhamadani, xhubleta e shumë pjesë të tjera që shoqërojnë ato. Na emocionoi, na shtoi mallin dhe na bëri pak nostalgjik monitori që shoqëroi këtë veprimtari, në të cilin pamë bukuritë natyrore të alpeve dhe të krejt Dukagjinit, të filmuara me profesionalizëm nga Mhill Vata (Caka).

Kjo natë e paharruar folklorike nuk mund të ishte e tillë pa ata që e organizuan, Ndue Shytani - drejtues organizativ, Luan Dakistani - drejtues muzikor, Fran Kodra - udhëheqës artistik, regjia e koreografia nga Aldo Nika, kurse moderatore Laura Plishta - shumë e saktë e profesioniste. Me kohë është thënë se cilësia e një kombi varet nga cilësia e kulturës që ka, ku arti është ushqim shpirtëror. Ata që mohojnë vlerat e trashëgimisë kulturore, mohojnë nga kanë ardhur dhe nuk dinë se nga shkojnë. Kjo veprimtari na përcolli me seriozitetin e duhur arritjet kulturore në fushën e krijimtarisë dhe interpretimit duke e pasuruar thesarin e trashëgimisë kulturore e folklorike të Dukagjinit. Do të ishte kjo natë tradicionale edhe më e plotë dhe cilësore nëse do të merrnin pjesë edhe disa këngëtarë të tjerë dukagjinase, të cilët janë vetëpërgjashtar për arsye absurde, paradoksalisht vetëm për arsye subjektive duke vënë mbi gjithçka fitimin në art.

Pra, pamë një koncert mbresëlënës. Me të tilla veprimtari e të tjera që dukagjinasi po bëjnë në Shkodër, shpejtojnë integrimin tonë në jetën urbane e rreth saj, përmirësojnë më shpejt imazhin tek ata që na quajnë të ardhur. Kështu do të kontribuojmë në ngritjen akoma më lart të emrit të Shkodrës, e cila vazhdon të krenohet me të kaluarën e saj të lavdishme, në të cilën është edhe kontributi i dukagjinaseve, si në art, kulturë, sport e në të tjera fusha të jetës kulturore e shoqërore.

Kemi besim të plotë se në të ardhmen do të kemi veprimtari të tilla akoma më cilësore e gjithëpërfshirëse duke pasur më shumë krijimtari e interpretim, duke e pasuruar akoma më shumë trashëgiminë kulturore të Dukagjinit e më gjerë, sepse kështu do e fitojmë vendin që meritojmë, dukë ngritë më lart vlerat tona e mbyllë gojën skeptikëve e paragjyksesve.

Prellë SHYTANI

Stani: Vendlindja, një dashuri që nuk mbaron kurrë

- NË KUADRIN E DALJES SË LIBRIT "RRUGË PA KRYE", ME ESE LETRARE -

Lazer Stani, pas shtatë vëllimeve me tregime, vjen para lexuesit me librin e ri me ese letrare "Rrugë pa krye". Lazer Stani, tashmë shkrimtar i njohur, ka një eksperiencë të madhe në fushën e gazetarisë, të publicistikës, anëtar redaksie në gazetën "Drita", në gazetën "Zërin e Rinisë", në gazetën "RD", në gazetën "Albania", e të tjera media të shkruara. Por mbi të gjitha, ai është shkrimtar, portretin e tij e bëjnë librat e shkruar prej tij, siç shprehet edhe vetë.

Kush është Lazer Stani?

Lazer Stani është Lazer Stani. Portretin tim e bëjnë librat e mi; aty jam unë me ankthet, misteret, imazhet, imagjinatën, ndjenjat, emocionet, vizionet, pikëpyetjet, hamendjet, mëdyshjet, dyshimet, mendimet, ëndrrat, fuqinë krijuese, me gjithçka, një botë që ekziston vetëm brenda meje, askund tjetër.

Tjetër gjë nuk mund të them për veten, ngaqë çdo shkrimtar e ka të pamundur të flasë për veten, të flasë e të shpjegojë librat e tij. Ndryshe do ngjaja me ato nënat që kanë një vajzë pamartuar dhe që rrinë e mburrin cilësitë e së bijës, virtutet e sojnitë e pashoqe kund në nëntë katunde rrotull.

Në të gjitha këto vëllime me tregime, nuk ka tregim që në to nuk gjendet Dukagjini, Pulti, vendlindja jote. Në vëllimin e fundit me ese letrare, shkon në Pragë, na del vendlindja - Gjurajt, shkon në Tokio, na del vendlindja - Gjurajt, bashkëbisedon me personalitete të fushës së letrave deri dhe me shkrimtarin Petro Marko e përsëri vendlindja, shkruan esë-në "Njeriu e Dosjes", na dalin traditat e vendlindjes, po kështu secila nga esetë, në hapësirën e vet deri tek i fundit "Dies Natalis".

Pse gjithë ky udhëtim te vendlindja?

Julio Cortazar, ka një esë, ku rrëfen se gjithmonë e ka parë botën me katër palë sy njëkohësisht: me sytë e fëmijës dhe me sytë e burrit. Nga një qenie e tillë, shkruan Cortazar, ose del një përbindësh, ose një artist, në rastin tim një shkrimtar.

E vërteta është se edhe unë e shoh kështu botën, me katër palë sy, me sytë e fëmijës dhe me sytë e të rriturit - burrit. Kjo bën që fëmijëria të jetë vazhdimisht e pranishme tek unë, të diktojë, fuqinë, magjinë, misteret dhe bukurinë e saj. Dhe kjo fëmijëri është vendlindja, shtëpia ku kam lindur, stërgjyshja, gjyshi, nëna, baba, motrat e vëllezërit, fqinjët, fëmijët, pleqtë, burrat dhe gratë e fshatit, që populluan jetën time deri në moshën katërbëdhjetë vjeçare. Është ajo tokë, që rrokunin sytë deri në kufijtë e horizontit; me arat, pyjet, përrenjtë, malet, kodrat, bjeshkët hijerënda të mbështjella me vellon e misterit. Dhe historitë që mbushin hapësirën dhe që unë i thithja së bashku me ajrin. Ndoshta kështu është

edhe tjetërkund, por unë nuk di vend tjetër që të ketë aq shumë histori për të rrëfyer: çdo rrugë, çdo shkëmb, çdo pyll, secila bjeshkë, secila shtëpi e secili njeri kishte historitë e veta. Edhe pemët gjithashtu kishin historitë e tyre; shpesh mbanin emra njerëzish, të atij që e kishte mbjellë, a të atij që kishte rënë e thyer qafën prej saj.

Nuk e di se si ka qenë për sytë e të tjerëve që janë lindur e rritur aty njësoj si unë, në të njëjtën vendlindje - Gjurajt, po për mua ka qenë e jashtëzakonshme, e pangjashme dhe e veçantë, e papërsëritshme kund tjetër. Dhe fëmija brenda meje, është njëkohësisht vendlindja brenda meje, një dashuri që nuk do të soset sa ta kem frymën. Është kjo arsyeja pse ajo është e pranishme kudo që jam unë: edhe në Tokio, edhe në Pragë, edhe në një takim a bisedë me miqtë e mi më të mirë, shkrimtarë ose jo.

Çfarë janë për ju traditat dhe sa duhet t'u rrimë peng, ndoshta jo fjalë e përshtatshme, por sa ne duhet t'u referohemi dhe të trashëgojmë ato?

Traditat vijnë prej thellësive të kohës; janë krijuar nga para-ardhësit tanë në kohë krejt tjetër, në rrethana krejt të tjera, në realitet tjetër historik. Në të shumtën e rasteve, është si t'i veshësh burrit këpucët e ngushta të fëmijës. Të shkaktojnë kallo në këmbë, nuk ecën dot me to. Që i vogël e kam ndjerë peshën e tyre të rëndë, shtypëse. E dija se sa të rritesha, të bëhesha zot i vetes, do të shkoja në vend tjetër për të jetuar ose, në rastin më të keq, do të rrezikoja, do të aratisesha. Është e qartë, traditat nuk janë krijuar rastësisht, janë krijuar në rrethana të veçanta historike dhe dramatike njëkohësisht. Për pesë shekuj, aq sa zgjati pushtimi Osman, Dukagjini ishte një zonë e lirë, nuk e njihte pushtuesin, por njëkohësisht jetoi i izoluar nga krejt bota tjetër, çdo herë i rrezikuar të zhdukej. Instinkti bazë që ka kontrolluar jetën ka qenë vetëruajtja, mbijetesja. Në kushte mbijetese për pesë shekuj krijohen tradita dhe kulte që i shërbejnë pikërisht kësaj - mbijetesës: mikpritja, solidariteti, trimëria, nderi, miqësitë, besa e të tjera. Pabesitë, tradhtitë, mungesa e nderit, apo frika, mungesa e solidaritetit, apo gatishmëria për të bashkëpunuar me pushtuesin, nuk i shërbenin mbijetesës së tyre si njerëz të lirë dhe të krishterë. Ndaj këto tradita u ngulitën fort në psikikën e njeriut, brez pas brezi u shndërruan në besim, në fe, në kult, edhe pse here, herë kishin karakter jo human dhe shndërrorëshin në pranga që të lidhin duart. Të imponoheshin me solemnitetin dhe autoritetin e tyre të padiskutueshëm.

Në fund të fundit ato edhe sot janë pjesë e historisë dhe e psikikës tonë,

por njeriu modern, që jeton në rrethana krejt të tjera, në hapësirën e qytetërimit të sotëm evropian, nuk mund të mbetet peng i së shkuarës.

Të marrin gjakmarrjen, për shembull. Me sa kam lexuar unë, për herë të parë në histori gjakmarrja përmendet në fiset beduinë të shkretëtirës së Arabisë. Të paktën këtë e dëshmon Karen Armstrong një nga historianet më të njohura të religjioneve. Një fisi beduin kur i vritej një mashkull nga një fis tjetër, ai detyrimisht do t'i vriste një mashkull të fisit vrasës për të ruajtur ekuilibrin midis meshkujve, ku viktimat e radhës nuk është vrasësi, po një mashkull i fisit. Pra gjakmarrja nuk vendoste drejtësi, por ekuilibër në numrin e meshkujve të fiseve. Unë nuk kam lexuar asnjë dëshmi se kishte gjakmarrje në fiset e arbrit, apo edhe në kohën e Gjergj Kastriotit. As në Statutet e Brishtit dhe të Shkodrës nuk trajtohet, pra me sa duket nuk ka qenë problem. Por në shekujt e tetëmbëdhjetë dhe të nëntëmbëdh-

ato fise që kurrë nuk i ishin nënshtruar sundimit osman dhe kishin ruajtur besimin e të parëve, fenë e krishterë. Por kjo është një temë e gjerë që kërkon studime serioze nga historianë profesionistë, që për fat të keq deri tani nuk e kanë bërë. **Disa nocione si "Besa", "Mikpritja", "Burrë", "Trim" e të tjera, që shpesh themi, se ne, Kombi ynë dhe në veçanti dukagjinasi mburren me to! Por veç virtuteve a kemi edhe nocione të tjera të cilat duhet t'i lëmë pas krahëve?**

Si çdo popull tjetër ne kemi virtute të spikatura, por kemi edhe dobësitë tona. Jemi njerëz. Them, edhe pse nuk kam prova, gjenetikiist jemi më të pastër si pasardhës të racës Illo-Arbënore. Për shkak të izolimit, ngujimit në male, refuzimit deri në vdekje të pushtuesit. Por pushtimi pesëshkullor, nëse nuk ka arritur të ndotë gjakun, ka arritur të fusë ndotje të tjera deri në skutat më të largëta. Ndotje në gjuhë, në zakone, në sjellje. Nga sabah e aksham e deri te penxhere, marshallah e millet. Dhe kjo armiqësi me njëri - tjetrin, ky refuzim i njëri - tjetrit, është kultivuar nga osmanët për shekuj. Të përçarë e në armiqësi me njëri - tjetrin, malësorët e krishterë, por edhe shqiptarët në përgjithësi, përbënin një rrezik më të vogël për pushtuesin. Në anët tona kemi një nëmë shumë të rëndë: "Hangsh vetin". Dhe ne si bashkësi jo pak e kemi "hëngër vetin".

Unë dua të besoj dhe të shpresoj se jo vetëm si individë, por edhe si bashkësi, dukagjinasi do të futen me guxim në rrugën e progresit, do të shohin me guxim nga e ardhmja, të çliruar nga ngarkesat e së shkuarës. Unë nuk di një bashkësi tjetër që ka dhënë kaq shumë individë të shquar në art, kulturë, letërsi, religjion, sporte me të cilët krenohet jo vetëm Dukagjini, por krejt shqiptarët. Emra të tillë si Ernest Koliqi, Martin Camaj, Frederik Rreshpja, Ndreka Luca, Tinka Kurti, Lin Delia, At Daniel Gjeçaj, Kardinal Mikel Koliqi, profesor Luigj Marleka, pader Benardin Palaj, Lin Shllaku, Mirash Vuksani e të tjerë, janë me të vërtetë korifinj të kulturës tonë për të mos përmendur emrat e më të rinjve që gjithashtu janë shumë.

Çfarë gjëje ju shqetëson më shumë sot, aktualisht, si shkrimtar, si qytetar?

Lista e shqetësimeve është e gjatë, por kujt t'ia thuash. Ne kemi humbur aftësinë për të dëgjuar. Jetojmë në një diktaturë shurdhimi, që është pothuajse e njëjtë me diktaturën ku liria e shprehjes ndalohej me ligj. Dhe një shoqëri e shurdhët, një shoqëri që ka humbur magjinë e fjalës, është shoqëri lehtësisht për tu sunduar, e prire të qeveriset nga diktatorë. E thotë mirë Eduardo Galeano: "Historia, në të vërtetë,



jetë, siç e dëshmon edhe At Zef Valentini, gjakmarrja bënte kërdrinë në bashkësitë katolike të Mirditës, të Dukagjinit dhe të Malësisë së Madhe. Fakt është se gjakmarrjen në Evropë e kanë pasur edhe dy ishuj të pushtuar nga arabët: Kreta dhe Sicilia. Për Kanunin nuk ka studime të thelluara, nuk ka një analizë që të provojë se çfarë është e shekullit të pesëmbëdhjetë ose më e hershme dhe çfarë është shtuar më vonë në vijim të shekujve, kur Shqipëria ishte e pushtuar nga osmanët, siç janë shtuar personazhe me emra të ndryshuar në Eposin e Kreshnikëve, që është fort më i lashtë se Pushtimi Osman. Fakt është se gjakmarrja rraskapiste, çonte drejt dobësitit dhe asgjësimit

Një jetë të tërë në mes njerëzeve

- Një bisedim me z. Pjeter Delia -

- A mund të na flisni për origjinën, jetën dhe punën në të kaluarën tuaj?

Sigurisht që njerëzit kanë origjinën, fisin dhe vendin nga janë. Unë me ato jam njohur në distance, me rrëfimin e prindërve, dhe dashurinë për njerëzit dhe vendin ma ka ushqyer im atë.

Unë kam lindur me 7 korrik 1939 në fshatin Lekaj të krahinës së Shalës, në zonën e Dukagjinit, në një familje të madhe patriarkale ku bënin pjesë më shumë se 50 pjesëtarë dhe që Kryetar shtëpie ka qenë gjyshi, Pjetrush Delia. Familja shquhej për harmoni. Ata ishin njerëz punëtorë dhe bujare, kishin lidhje miqësore dhe kumbarie me familjet më në zë të zonës së Dukagjinit. Në mesin e viteve 30 kjo familje e madhe kërkonte lëvizje, dhe këtë e bëri babai im, Dode Pjetrush me gruan e tij dhe atëherë tre fëmijë. Në fund të muajit shtator 1939 u larguan si emigrante ekonomike në Jugosllavi dhe u vendos me banim në rrethina dhe në qytetin e Pejës. Babai punoi si sharrëxhi në kombinatin e drurit në Pejë. Në shtëpi kishim një ekonomi me ca bagëti dhe jetonim normalisht.

Gjate luftës, në shtëpinë tone erdhën partizanë nga Shqipëria dhe ajo u kthye në një baze e luftës për partizanët e shqiptarë. Qeveria Jugosllave bëri disa reforma. Nga fundi i vitit 1947 filluan regjistrimet e popullsisë, ku kërkohesh ndryshimi i nënshtetësisë dhe i Kombësisë, ndërsa për fëmijët që kishin lindur atje i merrte përsipër shteti. Shume shqiptare u larguan për në Turqi e vende të tjerë në Evropë. Në këto kushte, Babai vendosi që të kthehej në Shqipëri. Ne erdhëm në Shkodër dhe duke qenë familje me shume fëmijë, baba zgjodhi jetën në fshat. U vendosëm në Nënshkodër, në fshatin Rranxa-Bushat. Atje na priten mirë, shteti na ndihmoi dhe babën tone e çuan në pune si mjeshtër në sharrat e Pukës, ku ka punuar derisa doli në pension. Ne, familja e jonë trajtohesh si një familje punëtoare. Unë, siç theksova më parë 8 vjet të fëmijërisë i kalova në Pejë. Në Rranxa-Bushat përfundova shkollën fillore, pastaj shkollën shtate-vjeçare, që atëherë ishte me baza

vullnetare, me shumë suksese. Ne shtëpi, unë merresha me punë. Kishim lope dhe dhi të buta, me një ekonomi shtëpiake, me të cilën bënim jetë normale. Më vonë do përfundoj gjimnazin në Shkodër.

Në shtator të vitit 1958, më morën në ushtri dhe më dërguan për të studiuar në Bashkimin Sovjetik, në shkollën e marinës



për anijet "Nëndetëse". Pasi na pajisen me pasaporta, na dërguan tek Dogana e Durrësit ku udhëtuam me një vapor turistik i quajtur Biello-Ostrov, që do të thotë Ishulli i Bardhë. Kaluam në detin Adriatik, hymë në detin Jon, pastaj në detin Egje dhe u ndalua tek porti Pirej i Greqisë, i cili ishte një port madhështor. Kur u ndezën dritat elektrike, dukej vërtetë një metropol madhështor në Athin.

Udhëtimi jonë vazhdoi 9 ditë e 9 net. Nga Pirej kaluam pranë Çene-Kalasë, ku nga ky port, vapori u përshëndeten me sirena. Ne pame bukuri të mëdha e te rralla natyrore. Pastaj nëpërmes detit Marmara shkuam drejt ngushticës së Bosforit, nga pamë Stambollin, qytetin e ndërtuar nga Perandori Romak Kon-

standini. Përjashtoj teprimet e objekteve të Kultit, ishte një qytet madhështor Evropian. Aty qëndruam shume kohë, sepse kishte shumë lëvizje vaporesh e anijesh. Kjo na bëri që ne ta shijojmë më shumë pamjen e natyrës. Pastaj u futem në Detin e Zi, shkuam në portin e Varna të Bullgarisë, më vonë drejt në portin e Konstancë të Rumanisë. që andej drejt portit Odesa të Bashkimit Sovjetik. Këtu zbritëm nga Bjello-ostrov (Vapori) duke marrë me vete mbresa dhe kujtime të pashlyeshme. Me një anije Ruse udhëtuam drejt qytetit të Sevastopolit, ku ishte shkolla e Marinës.

Në këtë shkollë filluam mësimet teorike e praktike. Pasi i kryem mësimet sipas programit, na pajisen me dëshmi dhe u kthyem në Shqipëri. Gjatë qëndrimit në Sevastopol, na organizuan shumë vizita nëpër qytete, Kolkoze dhe Sovkoze, në flotën Luftarake Sovjetike e të tjera. Në vitin 1959, me vaporin Cijatur u kthyem në Shqipëri dhe u vendosëm në bazën e marinës, në Pashaliman. Këtu u emërova në nëndetësen numër 4, në detyrën nënoficerit dhe së bashku me ushtarakët Sovjetike shërbeva gjersa ata u larguan. Gjate asaj kohe unë isha si aktivist i librit, se dëshira ime ka qenë LIBRI, për të cilin jam nderuar me certifikatën "Miku i librit", të cilën e ruaj si një kujtim të shtrenjtë.

Në vitin 1962 u lirova nga ushtria, u ktheva pranë familjes dhe aty qëndrova, sepse vëllezërit e mi ishin me pune larg shtëpisë. Unë vazhdova punën në kooperativën bujqësore në Barbullush, në punë të ndryshme. Më vonë u emërova drejtues i sektorit numër 2, Barbullush-Mal i Jushit, njëkohësisht dhe kryeja detyra partie të shtetit Monist. Aty ne, kishim ndërtuar shtëpi dhe nga mesi i viteve 70 arritëm 30 pjesëtarë familjeje, që e kalonin shumë mirë. Të gjithë vëllezërit ishim me shkollë e profesione të ndryshme.

Në vitin 1971 më doli e drejta për studime pranë shkollës së Partisë, në Tiranë. Aty vijova studimet 2-vjeçare, pastaj 1-vjeçare, për specializim në filozofi dhe kështu u pajisa me diplome e dëshmi.

Pasi përfundimit të këtyre studimeve, në fillim, më emëruan në pune në N. B. Bushat në detyrën e Sekretarit të Byrosë Partisë. Më vonë, më transferuan, po me atë detyrë, në krahinën e Pultit, zonë e Dukagjinit. Pas pak kohe, më transferuan në krahinën kufitare të Kelmendit, në të cilën punova deri në vitin 1978.

shkelen me këmbë, në një shoqëri që s'di ku ka kokën e ku këmbët, në një vend që orkestron nga duar të liga?! Askush. Po unë shpirtërisht jam i lidhur me atë pakicë të njerëzve që sfidojnë, që nuk nënshtrohen, kështu që them do të vijoj të shkruaj.

Kur isha i vogël i dëgjoja plakatin thoshin: "Ëndrrat që tregohen nuk dëftojnë". Pra, kam plane apo projekte, kam ëndrra, por ia lëmë kohës. Të shohim se sa do të jem në gjendje t'i realizoj.

I nderuar Lazer Stani, ju falënderoj për kohën që më kushtuat në këtë bisedë

Gjatë punës time jam përpjekur të zgjidhi nevojat, të mos cenoj ndjenjat dhe të ruaj traditat e mira përparimtare të banorëve e krahinave ku kam punuar. Nuk jam pajtuar me mendimet e veprimet burokratike, për këto kam gëzuar respektin e popullit.

Në vitin 1979 me emëruan instruktor i Komitetit të Partisë në rrethin e Shkodrës. Në vitin 1981 u emërova nëndrejtor në shkollën e mesme, në Vrakë, Gruemirë. Në fund të viteve 1980 jam emëruar në shkollën e mesme Postribë. Aty kam dal në pension.

Sigurisht pasi dola në pension, më kane aktivizuar me detyrat shoqërore, kam shkruar artikuj në median e shkruar. Edhe para viteve 90 dhe pas vendosjes së demokracisë kam shkruar artikuj në shtypin e kohës, në gazetën e qendrës dhe ato lokale, veçanërisht në gazetën "Dukagjini", ku kam pasqyruar veprimtarinë patriotike, shoqërore dhe historike të figurave të ndryshme, si edhe për natyrën, dhuntitë të cilat I gëzon Dukagjini dhe Shqipëria. Për këto. me rastin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë më kanë nderuar me certifikate "Mirënjohjeje".

Tani jam pranë familjes, kam 2 djem dhe një vajzë. Njeri nga djemtë punon dhe jeton në Belgjikë dhe e ka ruajtur nënshtetësinë Shqiptare. Kam mbesa edhe nipër, të cilët vijojnë shkollat. Krahas tyre kam kushërinj e shumë miq e dashamirës, me të cilët ruaj marrëdhënie miqësore. Mjetet e komunikimit na favorizojnë për një gjë të tillë. Unë, u jam mirënjohës si miqve të vjetër dhe te rinjve për miqësinë, respekt që më japin.

Me këtë rast iu uroj dukagjinaseve që të integrohen sa më mirë në shoqërinë ku jetojnë aktualisht dhe që kurdoherë të kenë parasysh të parët e tyre, vendin e origjinës, se ky vend, këta banorë meritojnë respekt e dashuri, e kaluar e tyre, e kaluara e saj është e lavdishme.

Profesor Pjetri, në përfundim të këtij bashkëbisedimi me një pyetje dhe një përgjigje, të falënderoj shumë për shembullin e mirë që keni dhuruar e po na dhuron. Lexuesi mund të thotë, një bashkëbisedim vetëm me një pyetje!? Po, sepse formimi juaj i përgjithshëm nuk të le shteg për të ndërpre e kjo ndodhe kur njeriu e jeton jetën me dashuri, punë dhe respekt.

Mbeteni shembull dhe ju falënderoj për kohën!

Bisedoj Roza Pjetri

◀ nuk thotë kurrë lamtumirë. Historia thotë "Shihemi më vonë".

Ka shenja të dukshme se ne po përsërisim historinë tonë të dhunshme. Njerëzit janë më pak të lirë se sa ishin dy dekada më parë. Dhe kjo është një arsye për t'u alarmuar. Kur zgjohesh në mëngjes dhe e ndjen se sot je më pak i lirë se dje, instinktivisht e ndjen se je futur në një rrugë pa krye. Diktaturat mund të kenë fasada të ndryshme, valëvitin flamuj të ndryshëm, por në thelb kanë të njëjtën përmbajtje; e bëjnë njeriun tërësisht të varur, e shndërrojnë në vegël të pushtetit, në vidhë në ingranazhin e makinerisë shtypëse.

Lazer Stani, sigurisht ka plane, projekte të tjera në fushën e letrave, në fushën e krijimtarisë, por edhe në jetën e tij. A ka mundësi të publikohen para lexuesit të gazetës "Dukagjini", apo është ende herët për to?

Çfarë plane apo projekte mund të kem tjetër veçse të shkruaj. Nëse ia dal të botoj një libër tjetër të ri, të ri për mua në radhë të parë, e pastaj edhe për lexuesin, do të jetë diçka e bukur. Asgjë nuk më kënaq më shumë se krijimi, të shkruarit në mënyrë kreative. E di se tingëllon disi absurde, ngjan me një çmenduri. E kush ka nevojë për librat, në një vend ku e bukura përbuzet, në një vend ku vlerat

mjaftë te rëndësishme, për mendimet tuaja të qarta në lidhje me çështjet që të parashtrova, te cilat janë mesazhe për sot dhe në veçanti për të ardhmen e bashkësisë dukagjinase, për brezin e ri, për brezat e ardhshëm.

Të uroj me faqe të bardha në punën tuaj krijuese dhe të na jepni sa më shumë vepra që ti shërbejnë sa më shumë edukimit të brezave, edukimit tonë atdhetar. Mirënjohje!

Bisedoj, Ndue Sanaj

Jo Dhuna: stil i një politike paqeje. Vit të mbarë o Shkoder

Vullneti dhe dëshira e mirë për të dhënë mesazhe dhe modele pozitive ia dalin edhe kushteve atmosferike të pafavorshme, të cilat ndodhën në ditët e para të muajit Janar të këtij viti, që po sa hymë.. Arqipeshkvia Shkodër – Pult dhe Komisioni për Drejtësi e Paqe zhvilluan veprimtarinë e përvitshëm kushtuar Ditës Botërore të Paqes. Këtë vit, më 9 janar.2017, ora 17.00 - 19.30 Arqipeshkvia Shkodër dhe Komisioni Drejtësi dhe Paqe në bashkëpunim me Bashkinë Shkoder, Teatrin Migjeni dhe Komunitetin Sant'Egidio zhvilluan aktivitetin **"Jo Dhuna: stil i një politike paqeje. Vit të mbarë o Shkoder"**, që i referohet mesazhit të Atit të Shenjtë Françesk, për Ditën Botërore të Paqes.

Marshimi tradicional i paqes nisi që nga Katedralja Shkoder. Përgjegjësja e Komunitetit Sant Egidio, Zj. Xhoana Marashi bëri të ditur për të gjithë ata që denjuan ti bashkohen këtij marshimi (*ndër ta klerikë, të rinj e të reja nga bashkësia, të rinjtë me aftësi ndryshe të Shoqatës "Projekti Shpresa", Instituti i Motrave të Nënë Terezës, Shoqata "Madonnina del Grappa" e të tjerë të interesuar*) qëllimi i të cilit ka të bëjë me sensibilizimin e të gjithëve për të kuptuar se konfliktet nuk janë për njeriun dhe gjithashtu për ti thënë jo terrorit që po ndodh në botë.

Arqipeshkvi i Dioqezës Shkoder-Pult, Imzot. Angelo Massafra në nisje të kësaj veprimtarie dha mesazhin e tij: *"Marshimi që ne bëjmë ka disa vite, e fillojmë këtu, vazhdojmë tek Instituti i Motrave Stigmatine dhe ndalemi tek Sheshi "Nënë Tereza" për të përfunduar tek Teatri Migjeni, për të paraqitur mesazhin e paqes të Papa Franceskut. Këtë vit fatkeqësisht kemi parë që në ca vende ka luftë copë e copë, me shumë krime me shumë atentate. Papa Francesku ka dhënë një mesazh: Jo dhuna, të jetë stili i secilit. Nëse ne dëshirojmë të kemi një botë më të re që viti në të cilin kemi hyrë të jetë vërtet i mbarë,, duhet të heqim nga zemra secili prej nesh ato inate, urretje që të jemi punëtorë të paqes. Ky është urimi. Dhe nëse në çdo familje do të fillojmë me gjeste të vogla të dashurisë, të mirëkuptimit, respektit, durimit atëherë do të jetë ndryshe jeta personale, familjare dhe shoqërore".*

Më pas, ndalesa e parë u bë tek Motrat Stigmatine ku fjalën e mori M. Dukate Radoja e cila vuri theksin se martirja stigmatine, Marije Tuci, e cila luftoi për paqen, që i tha jo dhunës dhe që shërben si një model. Gjithashtu ajo falenderoi të gjithë pjesëmarrësit që iu bashkuan këtij marshimi për paqen.

Ndablesa e fundit u bë tek Sheshi Nënë Tereza, drejt të cilit të gjithë të rinjtë dhe klerikët me pankarta në duar marshuan duke shpërndarë mesazhe paqeje dhe dashurie. Imzot. Massafra sërisht mori fjalën duke theksuar: *"Kjo ecje merr një tjetër kuptim dhe rëndësi., në një vit të mbushur me trazira dhe vrasje kudo në botë. Të kemi parasysh që të mos i përgjigjemi tjetrit me ngurtësi, jo të keqen me*

të keqe."

Në mbyllje të kësaj ndalesë, Imzot. Massafra ndezi një flakë të shpresës për paqe për ti thënë jo luftës. Më pas ftoi At. Nikolla Petani, po ashtu për të ndezur flakën e shpresës dhe për ta lëshuar në hapësirën e qytetit të Shkodrës me qëllim për të shpërndarë sa më shumë që të jetë e mundur mesazhin e paqes. Ky marshim u mbyll me koncertin festiv për paqen në teatrin "Migjeni", me titull **"Vit të Mbarë o Shkoder."**

Në Teatrin "Migjeni" u shfaq një koncert mjaft domethënës, i cili u drejtua nga gazetarët e moderatorët e mirënjohur, Simon dhe Eliona Shkreli dhe u realizua nga kujdesi i veçantë i Drejtorit të Drejtësi dhe Paqe, z. Luigj Mila dhe regjisorit, z. Aldo Nika.

Ky koncert u hap me një dokumentar kushtuar paqes të quajtur "Armëpushimi i Krishtlindjes". Nëpërmjet tij u përçua që të falësh është e mundur, pajtimi është

duhet të ketë njeriu në jetë. Ndër këto mund të përmenden: valle popullore nga Grupi i Valleve të Famullisë së Oblikës, Alesja Toma me këngën "Luleborë", talenti i këngës, Marjana Bega me këngën "Në çdo zemër njëherë troket", Grupi i Valleve, nga Famullia Bardhaj, fëmijët e Qendrës Kulturore "Pjeter Gaci", me një valle, të rinjtë e Famullisë së Zojës Rruzare, Bardhaj u paraqiten me një kërcim modern, Xhulia Pjetri me këngën "Më mëso të harroj". I ftuar ishte edhe këngëtar i dashur, Olsi Ademi, i cili këndoi "Grande amore" me zërin e tij të mrekullueshëm.

Ndër të tjera u shfaq edhe një reportazh i shkurtër mbi veprimtarinë 20 vjeçare të Komisionit Drejtësi dhe Paqe.

Në mbyllje, fjala iu dha Imzot Massafra dhe at Nikolla Petani, të cilët bënë thirrje për më pak lufta dhe dhunë në botë, për më shumë humanizëm për të varfërve, të pambrojturve dhe persona-

ata gjithmonë do të sillen egër jo vetëm kundra nesh, por edhe kundra botës. Le të depërtojë në zemrat e secilit mesazhi i Papa Franceskut; le të angazhohemi vëllezër e motra; të angazhohemi do të thotë që ta duam më fort njëri tjetrin.. Le të jemi ne të rinjtë e të rejat, motrat e vëllezëri, baballarët promotorët e paqes"

Ndërsa në fjalën e saj Kryetarja e Bashkisë, zj. Voltana Ademi iu referua dhe fjalës së Papa Franceskut duke thënë se sot më shumë se kurrë lind nevoja për të luftuar dhunën dhe për të qenë pranë atyre që kanë më shumë nevojë: *"Mesazhi i Papa Franceskut vjen në një kohë të vështirë jo vetëm globale, por edhe shqiptare. Vëmendja e gjithsecilit prej nesh në ndërgjegjen e gjithsecilit prej nesh është jo vetëm jo dhunë por mirësi, paqe dhënie dore përkundrejt atij që ka më shumë nevojë e sigurisht pozitivitet, mirësi, buzëqeshje sikur thoshte Nënë Tereza për gjithsecilin të afërmin, familjen, fëmijën, shokun e shoqen, miken, miqtë, të rinjtë për më të vjetrit, për ata që kanë nevojë, për të gjithë shoqërinë tonë"*

I gjithë veprimtaria, që u zhvillua në Teatrin "Migjeni" predikonte më shumë paqe në një kohë kur luftat dhe dhuna janë shndërruar në një mjet kryesor kudo në botë. Po ashtu transmetoi një mesazh me shumë rëndësi *"Të mësojmë që të komunikojmë me njëri-tjetrin"*. Ndryshimi nisët prej nesh, për të zhdukur çdo të keqe, por edhe atë më pak të dukshmen, sëmundjen e moskomunikimit me njëri-tjetrin



ve me aftësi ndryshe.

Imzot Massafra theksoi: *"Duhet që të kemi paqe në zemrat tona, pikërisht neve Ati i Shenjtë na bën thirrje me këtë mesazh për paqen 2017, me siguri ai flet edhe për një politikë për paqen duke i nxitur institucionet që të bëjnë programe zhvillimi të mbështetura në veprime të drejtësisë shoqërore dhe të sigurojnë punë për çdo njeri, por kjo thirrje u drejtohet në mënyrë të veçantë ndërgjegjeve të individëve jo vetëm politikanëve, dhe sheh familjen vendin ideal për të zhvilluar prirjen për jo dhunë"*

At Nikolla Petani shprehu: *"Në qoftë se ne do i mësojmë fëmijët tanë me egërsinë,*

Në mbyllje, bashkohemi me urimin që viti 2017 të vijojë me një stil të ri jete, të bëhemi persona që e kanë larguar nga zemra dhe nga mendja të keqen. Bashkohemi me mesazhin e Papa Franceskut, i cili i uron paqen çdo burri, gruajë, djali dhe vajze dhe që lutet derisa përngjasimi dhe shëmbëlltyra me Hyjin e çdo personi të na mundësojë që ta njohim njëri tjetrin si dhurata të shenjta të pajisura me një dinjitet të pafund. Sidomos në situatë konflikti, e respektofshin këtë "dinjitet më të thellë" dhe e bëfshim jo dhunën aktive stilin tonë të jetës.

Përgatiti: Suela NDOJA

"LULEBORË" NË QDO STINË

- RIKTHEHET NË SHKODËR PAS 27 VITEVE FESTIVALI I KËNGËS QYTETARE "LULEBORË" -

Një fund viti në Shkodrën tonë gjithmonë përjetohet me ngjarje të shënuara artistike, festive e qytetare, ku natyrisht do të përmendim evenimentet më të rëndësishme, siç është "Sofra Shkodrane" e cila plotësohet kaq bukur dhe natyrshëm edhe me sofrat e tjera përreth që në mënyrën e vet mbledhin rreth tyre qytetarë të pasionuar pas qytetit, humorit dhe ahengut, të cilët sfidojnë edhe hallet e përditshme për të gëzuar një natë së bashku.

Për këtë vit, Shkodra jonë sofrën e saj e kishte organizuar krejtësisht ndryshe.

Duke sfiduar stinën e ftohtë, nën kujdesin e një dore të ngrohtë dhe qytetare shkodrane, ishte përgaditur një buqetë me lule të bardha, të cilat ishin njëkohësisht edhe një buqetë këngësh, që sollën pas 27 vitesh para shkodranëve të dashuruar me lulet dhe këngët këtë ngjarje madhështore të titulluar "Luleborë".

Nuk kishte si të ndodhte ndryshe: dora aq e kujdesshme që mban edhe meritat dhe respektin e madh për organizimin e këtij eventi, natyrisht ishte Bashkia e Shkodrës, iniciuese dhe mbështetëse e kësaj ngjarje të madhe që mbylli kaq bukur këtë vit, ku natyrisht meriten kryesore duhet t'ja lëmë kryeqytetares së Shkodrës, vajzës së këtij qyteti znj. Voltana Ademi, që si të gjitha vajzat dhe djemt shkodranë ka përkëdhelur dhe mbajtur në dorë një buqetë luleborë.

Teatri "Migjeni", tempulli i artit shkodran, ajo shtëpi që me vite e vite me radhë ka rrezatuar freskinë dhe gjelbrimin e një fidanishteje që rrallë mund të gjindet në trevat shqiptare, këtë dhjetor kishte hapur përsëri dyert dhe krahët e skenës për të pritur për tre netë me radhë edhe një herë pas kaq vitesh këngën qytetare të Shkodrës, të cilën do ta sillnin me aq dashuri e profesionalizëm krijues të rinj dhe të vjetër, por mbi të gjitha zëra të rinj të mrekullueshëm që do të tregonin edhe një herë se kjo fidanishtë me lulet më të bukura të oborreve shkodrane, është gjithmonë në lulëzim.

Pas një përgatitjeje të gjatë, pas një përzgjedhjeje të krijimtarive për këtë eveniment të rëndësishëm, me dt.26 dhjetor u ngjiten në skenën e Teatrit "Migjeni" këngëtarët që do të promovonin këngët e këtij festivali kaq të shumëpritur.

Nata e parë, ashtu si edhe dy netët që e pasuan ishin magjike. Salla e tejmbushur me dashamirësit e këngës shkodrane, dallohej qartë se kishte vite që e priste një festë të tillë.

Sipas libretit të shfaqjes, natën e parë u kënduan 11 këngë me krijimtari të reja, gjithmonë të frymëzuara nga kënga tradicionale qytetare shkodrane, ku spikaste në mënyrë të veçantë interpretimi i këngëtarëve të rinj.

Kështu edhe me 10 këngë të tjera mbushi dhe entuziazmojë skenën dhe sallën e Teatrit "Migjeni" edhe natën e dytë.

Dy netë me këngë kaq të bukura, kaq të realizuara dhe kaq të freskëta u bënë një motiv i ngrohtë që nata finale të zbutte temperaturat e dhjetorit dhe salla e teatrit të ishte më shkodrane se kurrë. Organizatorët me zgjuars, në natën finale nuk

kishin bërë përzgjedhje të këngëve pjesëmarrëse, por kishin sjellur edhe një herë të gjitha këngët pjesëmarrëse, sepse të gjitha ishin njëra më e bukur se tjetra.

Kështu që e ashtëquajtura natë finale ishte në një farë mënyre vetë festivali.

I mirëpritur me vlerësime, duartrokitje dhe ovacione, i organizuar në mënyrën më të përkryer regjisoriale, i ndërthurur me historilun aq nostalgjik për shkodranët, nëpërmjet inserteve të kësaj pasurie që quhet kënga popullore qytetare shkodrane, spektakli arriti të bëhet eveniment i vitit dhe ashtu siç thamë në fillim, sofrat e vërtetë shkodrane.



Në një moment që pritej të jepej inserti kushtuar ikonës së këngës shkodrane, këngëtarit të papërsëritshëm Bik Ndoja "Artist i Merituar", Pandi Laço që drejtonte në skenë festivalin deklamoj para publikut një lajm shumë të gëzueshëm. Në këtë moment iu drejtua sallës ai: "Presidenti i Republikës së Shqipërisë z.Bujar Nishani i akordoi këngëtarit të madh Bik Ndoja titullin e lartë "Nderi i Kombit".

Të gjithë spektatorët në sallë u ngritën në këmbë dhe me duartrokitje dhe ovacione, nderuan birin e tyre, këtë figurë të madhe të trashëgimisë së kulturës shkodrane, të këtij artisti që edhe pse nuk jeton më, është i gjallë në çdo ngjarje të familjeve shkodrane me atë pasuri të madhe që ka lënë pas për të gjithë brezat.

Ndoshta ishte risi që një ndër drejtuesit, konferencierin i këtij festivali, ishte Pandi Laço, shoqëruar nga partnerja shkodrane Migena Bushati, pasi ky njohës i mirë i muzikës së trevave shqiptare, por edhe si përfaqësues i televizionit kombëtar "Klan", ishte ngjitur në skenë për të treguar se festivali i këngës qytetare shkodrane "Luleborë" nuk ishte një pasuri vetëm e qytetit të Shkodrës, por e gjithë shqiptarëve.

Këtë e mbështeste më së miri edhe një juri aq e nderuar, me emra kaq të mëdhenj, që u mirëpritën dhe u duartrokitën nga spektatorët në sallë. Për atë juri që e kryesonte një artist i madh, djali i një artisti të madh shkodran, këngëtarit Ibrahim Tukiqi, Genc Tukiqi u ngjit në skenë si në shtëpinë e vet dhe me intiligjencën dhe humorin e trashëguar, organizoi në mënyrën më të mirë të mundshme edhe zonën e "nxehtë" të promovimit të çmimeve, duke pasur për

krah figurat shumë të njohura si kompozitorin e shquar Adi Hila, këngëtarin Era Rusi, pedagogun dhe studiuesen Valbona Karaçiq dhe poetin shkodran Lisandër Kola.

Festivali i këngës qytetare shkodrane "Luleborë" kishte edhe një tjetër vlerë të madhe, ashtu siç i ka hije interpretimit të kësaj kënge kaq të mrekullueshme. Në "oborrin" e skenës të mbushur me luleborë ishte vendosur një orkestër e mrekullueshme, e cila me virtuozeitetin e vet i shoqëroi live të gjitha interpretimet, duke sfiduar "teknologjinë" dhe duke i dhënë hapsira të gjithë interpretuesve, e në mënyrë të veçantë atyre më të rinjve.

dhe u duartrokit si një djalë shkodran dhe bashkë me pjesëtarët e tjerë të jurisë shpalli edhe fituesit e festivalit.

Për të ardhur deri këtu ai falenderoi gjithë organizatorët dhe protagonistët e këtij festivali, duke veçuar ata që natyrisht për tre netë me radhë ishin më të mirët. Orkestrën e mrekullueshme që shoqëroi live të gjithë këngëtarët, të drejtuar nga maestro Ilir Zoga, i cili ishte edhe drejtor artistik i këtij festivali.

Kështu pra, në këtë atmosferë u shpallën edhe çmimet fituese:

"Nana", ishte titulli i këngës që fitoi çmimin e parë, kompozuar dhe orkestruar nga Zef Çoba, me tekst të Alfred Çapalikut, kënduar nga Erinda Agolli, Olta Juba dhe Kori "Rozafa Expression".

Me çmimin e dytë u vlerësua kënga "Për herë t'parë n'Shkodër kush vjen", kompozuar nga Bepin Vjerdha, orkestruar nga Ilir Zoga, teksti Osman Kozmaj, kënduar nga Leonora Luca dhe Niki Mjeda.

Çmimin e tretë e mori kënga "Mori Hylleshë", kompozuar nga Bardhyl Hysa, orkestruar nga Alfred Kaçinari, teksti Elna Çuliq, kënduar nga sopranoja Emiljana Palushaj.

Teksti më i mirë u shpall "Për ty Shkodër më rreh zemra" i poetit Agim Doçi "Mjeshtëri i madh", kompozuar dhe orkestruar nga maestro Edmond Zhulali, kënduar nga Rezarta Smaja.

Çmimin special e fitoi kënga "Edhe Rozafa ta ka lakmi", kompozuar nga Namik Jahja, orkestruar nga Shpëtim Saraçi, teksti nga prof.Fadil Kraja "Mjeshtëri i madh", kënduar nga Eduart Jubani.

Festivali i këngës qytetare "Luleborë" u shfaq për tre netë me radhë në Teatrin "Migjeni" si eventimi më i rëndësishëm i vitit, organizuar nga Bashkia e Shkodrës, nën kujdesin e kryetares së Bashkisë znj. Voltana Ademi, e cila kishte ngarkuar për realizimin e këtij eventi Qendren Kulturorë "Pjetër Gaci", me drejtor z.Sidrit Lohja, udhëheqsin artistik z.Bardhyl Hysa dhe punonjësen e pasionuar të kulturës pranë kësaj Bashkie znj. Brunilda Lleshi.

Regjia e këtij festivali iu besua z. Bledi Laço.

Dashamirësit e këngës shkodrane janë edhe biznesmenët që bashkëtojnë me artin e bukur shkodran dhe këta biznesmen do të ishin të pranishëm edhe në këtë eventim, duke dhënë kontributin e tyre financiar në realizimin e kësaj ngjarjeje kaq të shënuar, që mbylli kaq bukur këtë vit, që po lëmë pas.

Ishin pra të pranishëm si sponsor: Hotel Colosseo, Melgushi SH.P.K, Abi Bank, Albsig, Reklama "Terroti" dhe "Mulliri i Bardhë".

Kishte kohë që në qytetin e Shkodrës nuk organizohej një aktivitet i tillë, pavarësisht nga mundësitë e mëdha potenciale që ky qytet ka dhe ishte vetë kryebashkiakia znj.Voltana Ademi që i premtoi qytetarëve të saj se ky festival i këngës qytetare "Luleborë" do të jetë si një oborr i mbushur me lule erëkëndshme, që gjithmonë do të lulëzojë.

RAMAZAN ÇEKA

NË KUJTESË

Lumturimi i 38 martirëve dhe dekorimi i tyre nga Presidenti i Republikës, ishin ngjarje të rëndësishme për vendin tonë. Njëkohësisht ishte edhe vënia në vend e dinjitetit dhe respektit për ata të cilët u martirizuan se besonin në Zot. Duke u kthyer në kujtesë të atyre viteve, të cilat ne i kemi jetuar, ndonëse të vegjël, na kujtohen shumë ngjarje të asaj kohe. Në moshën 10 vjeç, ndihmoja priftin të zhvillonte meshën çdo të diel apo në ditë feste. Vishesha me rroba të bardha, të cilat ishin qepur enkas për mua. Që në atë kohë unë besoja në Zot. Njerëzit e pushtetit në fshat i bënin presion babait tim që të mos me lejonte se "feja është opium për popullin".

Ndoshta fjale radhë se ku e kishin lexuar, ka mundësi që as kuptimin nuk ja dinin. Me gjithë presionin e prindërve unë vazhdoja të shërbeja kishës dhe dukesha si një gjakua i vogël. Prifti që shërbente në Theth në atë kohë quhej Padre Sebastian Dedaj dhe ishte me origjinë nga fshati Dedaj i krahinës së Shkrelit. Ruaj kujtimet me të mira për sjelljen, dashurinë, respektin që kishte për të gjithë besimtarët. Një ditë e pyeta priftin në se besimet e tjera kanë atë Zot që besojmë edhe ne. Kuptohet se ishte një pyetje prej fëmijë 10 vjeç. Ai me buzëqeshje dhe me shpjegoj se Zoti është vetëm një. Pra edhe besimet e tjera kanë e besojnë vetëm në një Zot. Mënyra se si luten janë të ndryshme. E me gjithë atë ne i respektojmë të gjitha besimet e tjera. Pra i luten Zotit të gjithë e të gjithëve na ndihmoftë.

Ruaj një kujtim të veçantë për këtë njeri të Zotit. Unë isha në shkollë, nxënëse shumë i mirë në mësim. E pyesja sa gjuhë të huaja di, përgjigja ishte disa, e unë me naivitet i thosha, sa qeft do të kisha të mësoja edhe unë një gjuhë të huaj. Prifti udhëtoj për në Shkodër ku qëndroj disa ditë. Kur u kthye me solli një metodikë për të mësuar gjuhën ruse, autore e

(vijon nga f.3) Mendoj se kjo metodë pune e përdorur në këtë periudhë është e spikatur dhe hasësh radhë në një përdorim të tillë. Në thelb ka vullnetin e madh për të mësuar dhe mungesën totale të mjeteve mësimore.

Rezultatet përfundimtare të këtij kursi ishin shumë të mira për nivelin që kërkohej. Pa përjashtim, kursistët përvetësuan: për t'i shkruar 36 shkronjat e alfabetit shqip, për të shkruar dhe për të lexuar, të njohin numrat dhe veprimet e thjeshta aritmetike.

Me rritjen e nivelit arsimor nga fillorja në 7 e 8 vjeçare u krijuan mundësitë për një shkollim edhe më të mirë. Zhdukja e analfabetizmit është një sukses shumë i madhe për kohën. Më vjen çudi dhe ndjej dhimbje kur sot flitet për analfabet, sidomos te moshat e reja.

Mundësitë e thellimit të njohurive

saj ishte Nina Podapova. Kjo më ndihmojë shumë në shkollë të mesme edhe në fakultet. E kam takuar pas shumë vitesh, Padre Serbastjanin. Ai kishte kaluar një kalëvar të gjatë vuajtjesh duke përfundu-



ar marangoz në ndërmarrjen komunale në Shkodër.

Përjetuam prishjen e kishave, xhamive e teqeve, burgosjen e priftërinjve, hoxhallarëve, dervishëve e të tjerë. Me të vërtetë këto veprime të dikturës u përjetuan shumë keq. Megjithatë as kush nuk guxonte të fliste. Kjo dallohej në fytirat e prindërve tonë, të cilat ishin të vrenjtura, të ashpra, ku dallohej lehtë një urrejtje e brendshme ndaj atyre veprim-

ar marangoz në ndërmarrjen komunale në Shkodër. Përjetuam prishjen e kishave, xhamive e teqeve, burgosjen e priftërinjve, hoxhallarëve, dervishëve e të tjerë. Me të vërtetë këto veprime të dikturës u përjetuan shumë keq. Megjithatë as kush nuk guxonte të fliste. Kjo dallohej në fytirat e prindërve tonë, të cilat ishin të vrenjtura, të ashpra, ku dallohej lehtë një urrejtje e brendshme ndaj atyre veprim-

ar marangoz në ndërmarrjen komunale në Shkodër. Përjetuam prishjen e kishave, xhamive e teqeve, burgosjen e priftërinjve, hoxhallarëve, dervishëve e të tjerë. Me të vërtetë këto veprime të dikturës u përjetuan shumë keq. Megjithatë as kush nuk guxonte të fliste. Kjo dallohej në fytirat e prindërve tonë, të cilat ishin të vrenjtura, të ashpra, ku dallohej lehtë një urrejtje e brendshme ndaj atyre veprim-

meve të regjimit. Por nuk flisnin nga frika se e dinin mirë ku përfundonin. Moment të cilin e kujtoj dhe mu ka ngulitur mirë në kokë, ka qenë kur shkatërruan kumbonaren e hodhën në tokë kumbonën e kishës, e cila shërbente edhe për t'iu lutur Zotit, po ishte edhe një orë. Fshatarët kur binte kumbona e kishës dihej se ishte ora 12. 00. Thyen të gjitha ikonat dhe zbukurimet e saj. Kisha përfundoj në magazine. Siç tregonin kjo kishë gjatë çlirimit ishte përdorë si burg. Këtu u torturonin mizorisht të gjithë kundërshtarët e regjimit që po instalohesh. Madje një herë kjo u dogj, po në këtë periudhë. Të gjitha këto ndodhi, nuk e lëkundën besimin te Zoti, por i luteshin fshehurazi, duke u ruajtur hafijeve. Pas mbarimit të fakultetit ekonomik, me emëruan në rrethin e Tropojës. E di veten me fat që punova e jetova pothuajse 20 vjet në këtë rreth. Me ata njerëz të mrekullueshëm, bujar, besnik, të dashur dhe shumë të respektuar. Njëpërmes këtij shkrimi i falënderoj përzemësisht, dhe them me gjithë zemër Zoti i lartësorë gjithmonë.

Duke u kthyer përsëri te titulli i cituar më lart. Përjetova një moment të vështirë kur organizata e rinisë kishte vendosur të demaskonte Dervishin e Luzhës, në mënyrën më brutale e shumë poshtëruese, për një njeri që kurrë nuk i kishte bërë askujt keq. Ai ishte patriot që e donte shumë atdheun. Po ja që gjërat shkuan në vendin e tyre. Sot varri tij vizitohet nga mijëra besimtarë. Dekorimi i tij me medaljen "Nderi Kombit" nga Presidenti i Republikës, është një nder i madh që i behet atij dhe gjithë klerikëve në Shqipëri.

Shtysë për të bërë këtë shkrim ishte edhe publikimi i një shkrimi në fb, në statusin e saj nga Shkodra, gazetarja e njohur dhe njëkohësisht mbesa e ime, Esmeralda Mulaj Egro, kur po bëhej Lumturimi i 38 martirëve, të cilin po e përcjellim në këtë shkrim, i cili bënë fjalë për nënën time dhe gjyshen e saj. Ajo shkru-

ante:

"Mesha e sotme e lumturimit të 38 Martirëve, me solli në mendje gjyshen time të mirë. Ajo për asnjë moment nuk rreshti se besuari në Zot dhe i lutej atij. Gjyshja ka mbajtur gjithmonë rruzaret në qaftë, fshehura aq mirë poshtë rrobave. Para gjumit thoshte gjithmonë uratë, që mua me dukej si këngë, e para se të hante falënderonte Zotin, ndërsa ne qeshnim se si nëna fliste me veti. Ja pashë një herë rruzaret ndërsa bëhej gati për gjumë. Ajo me tha se janë "rruaza" dhe i kishte kujtim. Në vitin 1991 shkova për herë të parë në kishë në Mal të Zi. Ne duart e priftit pash të njëjtat "rruaza" që mbante gjyshja ime. Nuk ja ndava sytë gjatë gjithë meshës. Kur mesha mbarojë, prifti u afrua dhe me pyeti nga isha. I thashë nga Shqipëria dhe menjëherë i tregova se si gjyshja ime kishte një palë "rruaza" si të tijat. Por natyrisht shumë të vjetra e të modifikuara. Prifti më tregoi se ato nuk ishin "rruaza" por rruzare. Më tregoi se gjyshja ime nuk këndonte natën, por thoshte uratë, apo kur na dukej se fliste me veten, ajo nuk fliste me veti para buke por falënderonte Zotin. Ai prifti i mirë që nuk u mërzi asnjë herë nga qindra pyetje të mijat me fali dhe rruzaret. Me zi prisja të kthehesha dhe t'ia jepja gjyshes time e ti tregoja se isha edhe në kishë, në kishën që aq shumë do ta dëshironte të ishte. Kur ja dhashë, ajo nuk po e besonte. Me shikoj dhe dy lot i rrëshqitën nga sytë. Ajo kurrë s' do ta kishte menduar se mbesa e saj do ti sillte rruzare e do të shkonte në kishë. Më vonë për shkak të punës time pata mundësi ti sillja gjyshes time një palë rruzare që mi dhuroj Papa Ratzinger. Besova se kjo do ishte lumturia me e madhe për të. I mori, më falënderoj shumë dhe më tha se ato janë rruzaret e para dhe se nuk do të vinte asnjë palë rruzare të tjera sepse ato ishin dhuratë nga zoti. Ajo nuk besonte se do të kishte kurrë një palë të tilla e ti mbante pa pasur frikë. Gjyshja ime e mirë, pavarësisht vuajtjeve dhe dhimbjeve që përjetoi në jetën e saj, kurrë nuk reshti së besuari në Zot. Ajo sot është 96 vjeçe. Zoti të ndihmoftë gjyshja e ime. Ti je frymëzimi im. Askush nuk i ndalon besimtarët të besojnë.

Harmonie fetare në vendin tonë, janë diamanti më i çmuar në botë. Prandaj kjo harmoni duhet ruajtur e forcuar me tej".

Ndue ZIÇI

dhomave të fjetjes sipas kurorëve, pastrimi dhe sistemimi i rrugëve dhe lagjeve të fshatit, etj, etj, qenë vërtetë një aksion që vazhdoj gjatë, por edhe që doli shumë i suksesshëm. Edhe sot kujtohen mësuesit që shkonin shtëpi në shtëpi çdo javë dhe bashkëbisedonin me familjarët për përmirësimin e kushteve të jetesës.

Puna e bërë në këto 100 vjet për arsimin dhe kulturën në Dukagjin është me shumë vlera. Shoqata Atdhetare Dukagjini ka bërë punë të madhe që i ka hy evidencimit, studimit dhe publikimit të kësaj veprimtarie. Ajo duhet mbështetur nga të gjithë sepse gjithsecili ka për të thënë, jo diçka por shumëçka në këtë drejtim.

KOLË FUNIÇI

PSE ANSAMBLI TREVA U PËRZU NGA TEATRI NË BUNKER

- Vëzhgim -

Ky ansambël ka 14 vite që me sakrificë përkushtim, guxim është rritur dhe ka marshuar duke krijuar një traditë në jetën kulturore të qytetit tone. Si intelektual dhe krijues kam qene dashamirës dhe gjithë kritikët dhe oponencat ime në lidhje me shfaqet e tyre kanë qenë nga dashamirësia ndonjëse e di se nuk i kanë pare plotësisht në këtë prizëm. E di se me sa shume mundim e kanë gjetur rrugën për hyre në Teatrin "Migjeni". Paragjykimet dhe dashakeqësia, (jashtë kritereve artistike) ka bere që të jenë mysafirë të pa dëshiruar kur duhet të ishin të mirëpritur pasi veç i sollën pak oksigjen këtij tempull ka vite është në agoni. Puka, Fushe Arrzi, Lezha, Burreli, Vau - Dejës të gjitha Bashki me Pallat ose Shtëpi Kulture të trashëguar nga e kaluara të kycurave nga një kolkoz të ndryshkur pa as një shfaqje pa as një spektator, por me ndere me thanë me Drejtorë Kulture të kollarisur. Komuniteti



Dukagjinës jo vetëm pa as një përfaqësim politik, por as në Sektorin e kulturës në Bashkinë Buallice, por në antiteze nxjerrë një gazetë periodike kulturore të vetën në Qarkun e Shkodrës, boton çdo vit libra

letrare, shkencore e publicistik disa here me tepër se sa botojnë së bashku Puka, Burreli, Fushë Arrëzi, Burreli, Hasi, Kukësi (dhe për këtë jam dëshmitarë). Nga ky komunitet ka dalë një Ansambël me disa

emra që i kalojnë kufijtë e Shkodrës me një biografi të pasur shfaqesh suksesesh. Ky komunitet e ndjek me dashuri Ansamblin të vetë të cilin e mbajtur, ushqyer ngrohur me duartrokitje. Për çudi këtë vit nuk pati vend në Teatër apo u përzu?! Fakti ishte se "Treva" përfundoj në Pallatin Sportit i cili mund të jete bunker strehues i mire por për një koncert muzikore është një shëmtirë. As ansambli Treva aq me tepër publiku dukagjinës nuk e meritonin të përfundonin në një tunel betoni në një temperaturë -5 grade. Organizatorët me mire ta bënin në shesh se aty ku benë. Spektatorët e zjarrtë nuk duhej të kishin shkuar në atë gavitë betoni. Ndoshta duhet thirrë bujarisë dukagjinase që të bej edhe "Një Shtëpi Kulture" ashtu siç bëri dy monumentet e Camajit dhe M. Shpendit, ashtu siç po përpiqet të beje edhe rrugën Prekal – Breg Lumi. Po atëherë me thoni çfarë drejtin duam që jetojmë në këtë vend?!

Jemi tërësisht njerëz pa atdhe në tokën tonë!
Prelë Milani

SI SHKRUANIN PARAARDHESIT

- NJË URIM I MIGJENIT PËR VITIN E RI -



"Shok i dashtun, unë përgjithësisht nuk shkruaj urime, as për Krishtlindje as për Bajram, as për ditëlindje as për ndoj festë tjetër. Nuk shkruaj, pse urimet që n'ato ditë tan bota ban, nuk dija plotësohen një per qind se pothuaj të gjitha dalin nga hipokrizia. Bota ketë e din, por njësoj vazhdon të shkruajë urime. As për Motmotin e Ri deri tash nuk i urova askujt asgjë. Por kësaj here due të hyj në rrathen e njerëzve korrekte dhe t'u uroj shokve të mi Motmotin e Ri 1937.

- Së pari, t'uroj, shok i dashtun gjumin e ambël, që të mos ndëgjosh si gjëmojnë njerëzit nën barren e kryqave të vet tue mundunve, as britmen e ngadhnjysve në ketë jetë. Të mos ndëgjosh bumbullimen e Spanjës. Gjumin e ambël! Të mos ndëgjosh si afër teje gërset dhëmballa për

dhëmballë, nga të ftohtit. Pse atëherë duhet të pyesësh: moj dhëmballë, pse ndeshe për dhëmballë dhe gërset aq? E gjuha në vend të dhëmballes përgjegjet: pse asht ftohtë, zotni, e kur asht ftohtë, zotni, u hyn dreqi trupit, muskulave, nervave, zotni, dhe qashtu gërset dhëmballa për dhëmballë, zotni. Asht tepër banale të themi se mungon veshja dhe mbathja dhe zjarrmi, prandaj: gjumin e ambël, shok i dashtun.

-Së dyti mbas gjumit t'ambël, t'uroj - ç'asht dhe e natyrshme - të jesh i gëzuem, gjithmonë i gëzuem. Nga gëzimi i madh, në sentimentalizem, të puthish drrasat e dhomes e shtyllat, si bani Greta Garbo në filmin "Mbretnesha Kristina", kur shijoi dashunin shtazore (desha të them hyjnore, por njësoj asht). Aq i gë-

zuem, saqë bota të ta kenë zili dhe të thonë: oh, sa i lumtun asht! Të jesh i gëzuem edhe pse n'anë tjetër zemra të pëlset, si paljaços. Të jesh i gëzuem, se gëzimi yt u jep shpresa edhe tjerëve. Në rasë se tryeza e shkrimit të çalon, ti qeshu. Në rasë se e vetmja karrige që ke në shtëpi asht e shpueme dhe s'ke se ku te rrih, ti qeshu. Në rast se s'ke zjarm e ke të ftohtë, po, ti qeshu. Në rasë se ndonjë ditë, ashtu kot, të mungon dhe buka, ti merre për lojë, për shaka, dhe qeshu, qeshu.

Del në rrugë bile, në kryqzimin e udhëve, dhe qeshu, qeshu, qeshu, e bota do ta ketë zili dhe do të thotë: ah, sa i lumtun asht! E kur të të vijë në shtëpi ta shofi shkaku e gëzimit tand, do t'i kujtohet botes vetvetja dhe do të fillojë të qeshi kikikikakaka. Smundja e të qeshunit do të përhapet ndër të gjithë dhe njerëzit si majmunat do të hidhen përpjetë nga gëzimi... Dhe kështu uroj që vjetin 1937 ta kalojmë në gëzim, edhe se të smundë patologjisht."

poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi



Poezi nga Daniel Njebza

Dedikuar Nenës

Nga shtëpia iku djali,
Me la n' dorë një telefon,
M' tha do thërras sa herë tmerr madhi,
Por aj nenën se kupton.

Bir na e theve zemrën t' dyve,
E Nëna tash e ka do moshë,
Dua me t' pas këtu para syve,
Zemrën Prindit me ja shendosh

Sa herë ndizet aj ekran,
Zërin tan kur e dëgjoj,
Si me thikë zemra ma bën,
Dua me t' prek, por nuk t' shikoj.

Amanet Nëna ta len,
Kurrë mos fli pa bukë e ujë,
M' ke dhanë Fjalën një dite vjen,
Por ndoshta me t' prit nuk muaj,

Ti ke dal me kërkua jetën,
Nëna veç t' mirën ta donë,
Por kur Prind Ta shohësh veten,
Dhimbjen Anës ja kupton.

Jeta ...!

Jeta ...!
Jam ka dua diku me ik!
Ku askush s' mundet me m' gjet,
Gjak dhe trupin dua me shit,

Vetëm shpirtin ta kem te qet,
Besomë, bam me i pas mundësit,
Kisha shkua n' tjetër planet.
Me u kthye kurrë s' isha mërzit.

Ndarja

Athu te dehem me alkool,
Mbase shpirti kështu t' harron,
Shpirti vunë, heshtja nuk fol,
Prape se prape ndarja s' ndryshon!
Them vetes "maje veten"
Dhe ma për zemra t' është thye,
Krejt çka t' fala n' harrës mbeten,
Veç unë m' beta tu dashtë ty.

S' muaj me bë çka shpirti m' thotë,
S' kam fuqi se ti m' ke lan,
Ne c' do lot qe m: pikon sot,
Janë fjalë zemre qe s' janë than.

Zana e këtij dimrit ...!

Ah moj Zana e këtij dimri
emrin tënd nuk ma tha libri.
Ti që erdhe krejt papritur
kaq të egër s'të kam ditur.

Si ky dimër kurrë s'kam parë
ngrihet puthja si ujëvare
koha akull, ti je prush
sekretin se di askush.
Bora t' shkrihet përmbi qerpik
erë, acar e ti nuk ik...
fjala jote akull të ngrihet
kur buzëqesh fillon e shkrihet..
Kush ta dha adresën ty...
që na vret me ata sy.
Ti moj Zanë që vjen nga larg,
na ke zënë si zog në çark
Ah moj Zanë e këtij janari,
disa vargje po ti fali...
Me atë zjarr që në shpirt ke,
e shkrin borën përmbi re.
Ah moj Zanë moj zemërmire,
për të varfrit ki mëshire,
mbushe botën dashuri
shkrije borën, bëje shi!
Luash Brigja, janar 2017



Sofia Doko Arapaj,
Tyliso Iraklio, Greqi

Më fshih

Me fshih
nën lëkurën tënde
më bridh veç ku do ti,
të jepem e tëra, shpirt,
sepse, vetëm ti më kupton
Kam shekuj pa prekur
dyert e braktisura
pa kënduar shqipen,
e puthur tokën tonë

oh... oh... vetëm ti
ti më bën vërtet
vërtet, vërtet të qaj
te të ngulem thellë në gji
të plas në lot, në vaj
të ndjej Beki Fehmiun
në dete ulërimash
të prek në trupin tim
kafshim - dhimbje sirenash ...
tregoju zogjve zemër
ku do më treten gjinjte
kur loz e qesh me erën
si dallga prek shkëmbinjte
kur vajza Armene
këndoi për Shqipërinë,
që atëherë zonjë – kështjella
la verë, filloj rakinë ...

Oh... oh ...

më fshih
nën lëkurën tënde
më bridh veç ku do ti,
të jepem e tëra, o shpirt,
sepse, vetëm ti më kupton
Kam shekuj pa prekur
ëndrrat e braktisura
pa kënduar shqipen,
pa puthur tokën tonë...

S i dihet

Aj, të lahem të dy, tani në dush
ujë të ngrohtë dhe një shpirt sapun
ti njomim flokët e rrallë, të butë
lule - flluskash të lozin neper shkumë...
Oh, si shkëlqen fytyra jote, po të them,
më kruaj pak shpatullën, se kam guduli,
shpërthime ylberesh, kanë mbërthyer
dhenë,
mbi gishtat e avujt, o zot c mrekulli!
Të lahem pse jo, tani në dush
si dy të vegjël, të urtë, jetimë,
se nënën na e morën çakejtë,
se njerkat ... na lanë pa gëzim....
Si dihet, cili qiell na merr,
si dihet kush trupin do na laj,
më puth sa jam ende e qeshur,
të çelem çdo mars edhe maj...
Eja, të lahem të dy, tani në dush
ujë të ngrohtë e një shpirt sapun
ti njomin flokët e rrallë, të butë
lule-flluskash të lozin nëpër shkumë...

Pjetër Mehmeti

Fiset e Shalës rritën burra
I njofti besa, ndera e lufta
E kuvendi e urtia
Vlera mori gjithë malësia
Në kulla guri me frëngji
Zemrën flakë, mënden duhi
Kanë lanë emën në histori
Në porta të nalta e krajl
Nuk i mposhti krajl as mbreti
Kudo ranë ia kanë lanë veti
Fisi Pecaj, fis i parë
Patriot shpirt atdhetar
Në ballë të luftës fitimtar
Në ditë të vështira të qëndrimit
Kundër të huajve në ballë t' luftimit
I prinë Shalës e Dukagjinit
Të parë në luftë e log t' kuvendit
Shkëlqej mendja e Mehmet Shpendit
Me aftësi i dual Zot vendit
Pjetër Mehmeti djali i tij
U rrit n' vatan me shumë burrni
I ka ruajt dhe i dhanë lavdi
Në Nikaj-Mërtur e vendosi jeta
Aty i rriti vlerat e veta
Me ata burra të t' asaj krahine
Zonë bujare edhe trime
Burra bese, lufte e kuvendi
I respektoj i huaj e vendi
Në moshë të re, por burrnor
Trim besnik dhe kanunor
I dhanë respektin e lavdinë
Bafti Nduen me Ik Delin
Në krye të kuvendit, si më të mirin
Me Fetë Sadikun e Syl Martinin
I vlerësuan fjalën e mendimin
Erdh një kohë, solli ndryshime
Ngjarje të ndryshme me trazime
Për patriotë filluan dyshime
Kur në pushtet erdh diktatura
Nuk i njofti mirë do burra
Për ide u shfaq rreziku
Filluan grindjet e konflikti
Komunisti e nacionalisti
Shumë telashe vendit i qiti
Duel jashtë loje patriotizmi
Nacionalisti me ideal shqiptar
U quajt armik e tradhtar
Vëllai me vëlla humbën respekt
I kapi etja për pushtet
Shumë trazime solli jeta
Për mendime të vjen vdekja
Ligje të ashpra vendosi shteti
O me ne , ose jeta të treti
Frika në shpirt njeriut i hyni
Filloi burgimi dhe internimi
Me ruajt fenë e idealin
Shumë patriot morën malin
Fatkeqësia burrat i gjeti
Patrioti Pjetër Mehmeti
Në arrati duel e treti
Nëpër male, ku rrinë zana
Për ma trim se lind nëna
18 burra i ka në çetë
Nuk dorëzohen pa vdekë
Trima t' fortë thua lind prej gurit
Krenaria e Nikaj-Mërturit
Besnik shqipes dhe flamurit
S' pat pushtet hovin t' u ndali
Nik Sokoli e Mark Tunxh Myftari
Gjelosh Noshi e Shpend Sadiku

+

Nacionalistë me ideal
Nuk pe dine ç' asht rreziku
Zef Marku e Fran Ukshini
Kurrë s' ia kthyen hasmit shpinën
Për këta burra vazhdon ndjekja
Shumë rreziqe kaloi çeta
Në kushte të rënda të qëndresës
Disa herë me forcat e ndjekjes
Tujë jetua çastet e vdekjes
Nëpër shpella, qafa e male
Një përpjekje ishte e madhe
Në Curraj Epër te do stane
5 dhjetor '46 (1946)
Aty një stan mori flake
Ku gjithë çeta ishte bashkë
N' rrezik të madh çeta ka ra
Pushka e bomba pa u nda
S'po ka shpresë lufta të ndalet
Ç' po qëndron ai burrë Shalet
Ka vendosë me qëndrua
Për t' gjallë armët mos me i lëshua
Për vatan asht betua
Me bë deken pa u marrua
Për krah ka një burrë si motit
Flakë i qet gryka e barotit
I lutet Shën Kollit e mëshirës së Zotit
Mos me u koritë ditën e sodit
Asht Mark Sadiku i Bëtoshës Mërturit
Për ma trim s'ke çka i thua burrit
Po qëndron si e ka zakon
Mitrulozin gjallë se lëshon
Pa pushim ashpër po qet
Me u hapë rrugë shokëve të vet
Pjetër Mehmeti thekshëm po thërret
Dilni burra, po qëndroi vetë
E mbuloi flaka edhe tymi
Gra e fëmijë i kapi trishtimi
Morën gjamë maja e lugina
Si në shtrëngatë shkrepë vetëtima
Situata u bë e rëndë
Morën forca e mësyni n' këmbë
I dolën hasmit ballë për ballë
Nuk dorëzohem për të gjallë
Me guxim çeta ka dalë
Për shokët e vet bëni qëndresën
E për vatan e mbajti besën
Me armë në dorë e mbylli jetën
Si hero e bëni vdekjen
Nderoi Shalën e pagoi veten
Ky nacionalist shpirt patriot
Nikaj-Mërturi e deshi fort
Po ka dhimbje dhe derdh lot
E Dukagjini po e qa
Edhe Shala që e pat vëlla
Kush e njofti e ka pa
Jehonë dha ajo qëndresë
Një trimëri që s'ka harresë
E kujtojnë burrat e djelmnia
Me respekt shkruan historia
I nderohet në shekuj lavdia.
Pjetër Geraj –Belgikë

KRESHNIKU I DUKAGJINIT GJON MARASHI

*Ky poemth, i kushtohet fisit
LOGU, kryesisht djemve te tij, niper e
mbesa, mikut tim Martinit, Marios, nip
Xhoelit, gjitonet e mrekullueshëm, këtu
në Fier, nder e lavdi Tëpareve tuaj!*

Merrem moj Shqiponjë sot,
Merma zemrën ngjitem në male,
të ndalem atje në t' bukrin Shosh,
ku janë kullat n' shkamb krenare..
Ku i kanë trojet kreshnikët,

këndon bilbili maje frashni,
sofrës besa çelik lidhet,
t' bajmë kuvend me Gjon Marashin..
Burri ma fisniku i fisit,
Lindi e rrit me krisma mauxerri,
Fort i pashëm, shtatin si lisi,
Duh e furtunë si veri..
Qysh i ri, kur ish djalosh,
Doli në krah të memedheut,
të parit, Perkah Mehmet Shpendit luftoi,
Si dragua në Qafë të Agrit..
Ai u rrit ndër luftna të rrepta,
Kundër turqeve, Malezezeve,
Se e kish folenë në kreshta,
Se trimërinë gjakut ndër deje..
Ai trim i Pavarsisë,
Nuk e lshoi pushkën motit
Kundër mbretit e tiranisë,
shte në krahun Fan Nolit..
Ishte në ball të çdo beteje,
Ku e lypi Dukagjini,
Muar dy plagë e doli në kreje,
Nuk e ndalte plumbi trimin..
Gjithë paria anë më anë,
Ia ndien zanin qeti burri,
gJithë e prisnin besë në kambë,
mik i shtejtë i Bajram Currit..
Heu në Luftën Çlirimtare,
Ishte i pari partisan,
Dhe luftoi në gryka e male,
N' ball të çetave si luan..
Gjithmonë kryet e mbajti nalt,
Nalt si bjeshët mblue me borë,
Shpia e tij atdheut i dha,
I dha nder, i dha dëshmorë..
Gjon Marashi burri i besës,
Kudo ishte n' ball kuvendi,
Fjala ar qysh në krye të herës,
Dritë e shpresë në zemra ndezi..
Dhe si prijës në Dukagjin,
E ka thanë fjalën me nder,
përfaqësuesi ky burrë trim,
n' tanë Shqipni pati vlerë.
U vlersua , u nderua,
Si si shqiponja në qiell me flatra,
Gjoksi tij lulnajë mbi krua,
Ishte mbushur dekorata..
Ishte e mbeti veteran,
Hero i gjallë në disa lufta,
Hije i pati, fjala e pushka,
Hije kanga dhe lahuta..
Ai shkam përmbi Shosh,
Ajo bjeshkë dhe ajo kreshtë,
Monumente qëndrojnë në mote,
Gjon Marashi i gjallë është..
Se nuk vdesin kurrë kreshnikët,
Se nuk vdes kurrë Liria,
Rron Gjon Marashi , rrojnë fiset,
Dukagjini dhe Shqipëria..
Brezat sot kudo shpërnda,
Tanë Shqipnisë e botës mbarë,
Për Gjon Marashin krejt pa nda,
Besnik janë , janë krenar !
Moj shqiponjë, o moj zonjë,
N' Shosh pse dola a e kupton,
për Gjon Marashin si buronjë,
kënga rrjedh e nuk pushon..
Për atë burr me kullë te guri,
Krenon bjeshka, krenon vrrini,
Ai asht n' zëmër të flamurit,
Kuq e zi si Dukagjini..
Gjon Marashi, fisi i Lekës,
Rranjë te gjaku e trolli i Shoshit,
I skalitun në jetë të jetës,
Shkamb rrezitun n' kranuer t' Kombit.
Fran Ukcama

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra,
Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh Kimay
PRODUCTION Produzione Giacche



+